

**RELACION MBI BUXHETIN E  
BASHKISË KORÇË TË VITIT  
2023 DHE PBA 2023-2025**

**DHJETOR 2022**



BASHKIA KORÇË

**Përmbajtja e buxhetit vjetor 2023 dhe PBA 2023-2025**

1.	Hyrje	4
2.	Kuadri ligjor	7
3.	Parimet themelore të financave të vetëqeverisjes vendore	7
4.	Buxhetin vendor 2023	7
5.	Buxhetimi gjinor	9
6.	Të ardhurat e veta të Njësisë të Vetëqeverisjes Vendore	9
6.1.	Të ardhurat nga taksat dhe tarifatat vendore	9
6.2.	Të ardhurat nga institucionet e vartësisë	33
6.3.	Transferta e pakushtëzuar	33
6.4.	Transferrat e pakushtëzuara sektoriale	34
7.	Buxheti 2023	37
7.1.	Dokumentacioni bazë:	40
7.2.	Dokumentacioni shoqërues	44
8.	Buxheti i Bashkisë Korçë për vitin 2023	52
8.1.	Programi: Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi AA122	53
8.2.	Programi: Siguria publike AB 122	56
8.3.	Programi: Mbështetja për Zhvillimin Ekonomik AC122	58
	Fondi rezervë 04910	69
	Fondi i kontigjencës 04940	69
8.4.	Mbrojtja e Mjedisit AD122	70
8.5.	Programi: Shërbime Publike Vendore AE122	72
8.6.	Programi: Arsimiti Bazë dhe Parashkollor AG122	74
8.7.	Programi: Arsimiti i Mesëm i Përgjithshëm AH122	76
8.8.	Programi: Përkujdesi social AI 122	80
9.	Buxheti për institucionet e varësisë për vitet 2023, 2024 dhe 2025	97
9.1.	Ndërmarrja e Shërbimeve Publike	97
9.2.	Klubi Shumësportësh	100
9.2.1.	Programi: Kultura Sporti dhe Argëtim AF122	100
9.3.	Qendra e Artit dhe Kulturës	102
9.3.1.	Programi: Kultura, Sporti dhe Argëtim AF122	102
9.4.	Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse e Arsimit dhe Çerdhes	106
9.4.1.	Programi arsimiti parashkollor bazë AG122	107
9.4.2.	Programi: Arsimiti i Mesëm i Përgjithshëm AH122	117



## BASHKIA KORÇË

9.5.Qendra Ditore dhe Qendra Rezidenciale e Zhvillimit	121
9.5.1 Programi:Përkujdesi Social AI122	121
9.6.Shtëpia e Foshnjës	122
9.6.1. Programi:Përkujdesi Social AI122	122

### **Lista e tabelave**

Tabela 1: Transferta e pakushtëzuar e përgjithshme (vlerat në 000/lekë) .....	33
Grafiku 1: Transferta e pakushtëzuar e përgjithshme .....	33
Tabela 2: Transferta e pakushtëzuar e sektoriale (vlerat në 000/lekë).....	34
Grafiku 2: Transferta e pakushtëzuar sektoriale .....	35
Tabela 3: Burimet e financimit (vlerat në 000/lekë).....	37
Tabela 4: Shpenzimet sipas llogarive ekonomike (vlerat në 000/lekë) .....	38
Tabela 5: Shpenzimet sipas institucioneve (vlerat në 000/lekë).....	39
Tabela 6: Fondet buxhetore, të parashikuara sipas programeve buxhetore për çdo njësi shpenzuese, për vitin e ardhshëm, të ndara në korrente dhe kapitale (vlerat në 000/lekë) .....	40
Tabela 7: Përmbledhëse e të ardhurave dhe shpenzimeve (000/lekë) .....	41
Tabela 8: Numri i punonjësve buxhetorë, për çdo njësi shpenzuese të njësisë së vetëqeverisjes vendore, për vitin e ardhshëm.....	43
Tabela 9: Llogaritja e efektit financiar të përjashtimeve ose lehtësimeve fiskale vendore .....	44
<i>Listën e njësive shpenzuese të njësisë së vetëqeverisjes vendore:</i> .....	45
Tabela 10: Përmbledhje e të ardhurave, shpenzimeve dhe subvencioneve të shoqërive në pronësi të bashkisë .....	51



## BASHKIA KORÇË

### 1. Hyrje

#### **Vështrim i Përgjithshëm i Bashkisë Korçë**

Bashkia Korçë ndodhet në qarkun e Korçës, në pjesën juglindore të Shqipërisë, në një sipërfaqe prej 805.99 km<sup>2</sup>, me shtrirje veri-jug 30 km dhe lindje –perëndim 53 km. Në veri kufizohet me bashkinë e Maliqit, në lindje me bashkinë e Devollit, në jug me bashkinë e Kolonjës, Përmetit dhe në perëndim me bashkinë e Skraparit. Vendodhja gjeografike ka luajtur një rol të rëndësishëm në zhvillimin e territorit. Nëpërmjet rrjetit rrugor Korça dhe rrethinat lidhen me kryeqendrën e vendit, Tiranën në veri dhe qendrën e jugut Gjirokastrën. Në të njëjtën kohë pozita gjeostrategjike, në një zonë ndërkuftare me Greqinë dhe Maqedoninë e Veriut, ka bërë që në të, të kalojnë akse të rëndësishme të komunikacionit që lidhin Shqipërinë me Ballkanin Juglindor e më gjerë. Qyteti i Korçës është qendra më e rëndësishme e qarkut dhe njëkohësisht një nga qendrat më të rëndësishme ekonomike dhe kulturore në Shqipëri.

Në aspektin fiziko-gjeografik territori i bashkisë përfshin disa njësi, si: shpatin perëndimor të malit të Moravës, pjesën jugore të fushëgropës së Korçës, malësinë e Voskopojës dhe malësinë e Vithkuqit. Lartësia e relievit shkon nga 500 m (përroi i Panaritit) në 2383 m (Mali i Ostrovicës), ku amplituda hipsometrike është 1883 m.

Klima dallohet për tipare mesdhetare, paramalore dhe malore me një ndikim të klimës kontinentale, sidomos gjatë periudhës së ftohtë të vitit. Territori i bashkisë bën pjesë në pellgun ujëmbledhës të lumit Devoll dhe lumit Osum, ku një nga degët më të rëndësishme ujore është Dunaveci. Përbërja e tokave është e ndryshme dhe variojnë nga brezi i tokave të kafenjta, të murrme pyjore dhe livadhore malore.

Në aspektin administrativ bashkia Korçë përbëhet nga 8 njësi administrative si Korçë, Drenovë, Qendër Bulgarec, Voskop, Voskopojë, Lekas, Vithkuq dhe Mollaj, në të cilat bëjnë pjesë një qendër urbane/qytet dhe 62 vendbanime rurale/fshatra. Popullsia e bashkisë është 129.065 banorë. Zhvillimi ekonomik bazohet tek disa sektorë të zhvilluar siç është bujqësia dhe blegtoria në zonat rurale, tregtia, ndërtimi, sektori agropërpunues, tekstilet dhe turizmi. Përmirësimet në infrastrukturë kanë lehtësuar jo vetëm përdorimin e burimeve natyrore por kanë nxitur zhvillimin e turizmit në zonat malore me interes të veçantë.

Vlen për t'u theksuar se turizmi është një ndër sektorët ekonomik, që po zhvillohet me ritme të shpejta. Qyteti i Korçës si edhe fshatrat përreth, Voskopoja, Dardha, Vithkuqi, Boboshtica dhe të tjera, ofrojnë pasuri të shumta kulturore dhe natyrore, që po rrisin gjithnjë e më shumë praninë e vizitorëve vendas dhe të huaj. E përcaktuar tashmë si destinacion turistik në zhvillim, bashkia Korçë ofron mundësi dhe sfida drejt zhvillimit të një turizmi të qëndrueshëm, çka do të ndikojë në rritjen e të ardhurave dhe përmirësimin e jetës së komunitetit në territorin e saj.

Hartimi i buxhetit për vitin 2023 vazhdon të jetë një sfidë për Bashkinë Korçë si për çdo bashki në vend. Nisur nga kjo, ne jemi përpjekur të planifikojmë një buxhet ku pavarësisht të ardhurave të reduktuara e nevojave të reja të paraqitura përballë nesh në këto kushte, banorëve të territorit të bashkisë, në qytet e fshatra të mos iu mungojnë shërbimet, kujdesi social aq i domosdoshëm në këtë periudhë, si edhe investimet e domosdoshme.

Korça prej vitesh ka hyrë në një rrugë të konsoliduar të zhvillimit të saj dhe pavarësisht kushteve të reja, bashkia Korçë do të bëjë më të mirën edhe këtë vit për banorët e territorit të saj në qytet dhe fshatra.

Në planifikimin buxhetor, bashkia ka prioritarizuar shërbimet dhe kujdesin social pa lënë mënjanë përmirësimin e infrastrukturës, duke rivalizuar dhe kthyer në identitet, vlera të çmuara të trashëgimisë



## BASHKIA KORÇË

urbane, që e dallojnë Korçën nga pjesët e tjera të Shqipërisë, si edhe duke krijuar vlera të reja të cilat i kanë dhënë Korçës një dimension të ri, në qytet dhe fshat. Në kushtet e shtimit të vështirësive ekonomike për familje e biznese, Bashkia ka orientuar buxhetin e saj në shërbime ndaj komunitetit, shtresave në nevojë, çerdhe, kopshte, shkolla, qendra për moshën e tretë, duke i qëndruar kështu më pranë nevojave të banorëve.

Veç ndërhyrjeve në infrastrukturë në vëmendjen tonë edhe këtë vit do të jetë edhe sektori i teknologjive të informacionit. Pranë qendrës së teknologjisë dhe inovacionit, e cila do të plotësohet gjatë këtij viti dhe me vënien në funksionim të ish godinës së prefekturës, ka marrë jetë një program i plotë trajnimesh për fëmijë dhe të rinj. Kjo falë edhe mbështetjes së partnerëve tanë brenda dhe jashtë Shqipërisë, interesi i të cilëve në këtë drejtim është edhe më i madh, për të mundësuar trajnime dhe mundësi punësimi për të rinjtë në fushën e teknologjive të informacionit.

Zhvillimi i turizmit në këto vite ka qenë dhe vijon të jetë një drejtim i rëndësishëm i Zhvillimit ekonomik për Korçën, kështu që do të vijojë të jetë në vëmendjen tonë edhe për vitin 2023.

Numri gjithnjë në rritje i vizitorëve ka shtuar jo vetëm numrin e bizneseve të shërbimit turistik dhe të ardhurat për ofruesit e këtyre shërbimeve, por ka imponuar edhe nevojën e orjentimit të një pjese të rëndësishme të buxhetit të Bashkisë në drejtim të mbështetjes për turizmin. Kemi planifikuar një paketë të plotë eventesh në qytet dhe fshatra, të shtrirë në të gjithë muajt e vitit. Një kalendar të pasur me aktivitete kulturore e sportive jo vetëm lokale, por edhe kombëtare e ndërkombëtare, kanë për qëllim jo vetëm ruajtjen dhe promovimin e vlerave më të mira të traditës, por sidomos promovimin e Korçës si një nga qendrat më të rëndësishme kulturore e turistike në Shqipëri.

Vëmendje të veçantë në buxhetin e vitit 2023 do të kenë projektet e infrastrukturës në fshatrat pjesë e Bashkisë së Korçës, me synimin që sa më shpejt të afrojmë infrastrukturën e tyre me atë të qytetit. Projektet e ujësjellësave, që synojmë ti përfundojmë këtë vit, së bashku me ato të ndricimit publik, kanalizimeve dhe rikonstruksionit të rrugëve, do të japin një kontribut në këtë drejtim, ndërkohë që po aq të rëndësishme do të jenë edhe shërbimet dhe projektet në ndihmë të bujqësisë dhe fermerëve.


Me administrimin efektiv të buxhetit të saj si edhe me mbështetjen e qeverisë dhe donatorëve, Bashkia Korçë edhe gjatë vitit 2023 do të zbatojë programe e projekte të rëndësishme zhvillimi, pjesë e vizionit të saj strategjik për zhvillimin e Korçës dhe përmirësimin e jetesës së banorëve në qytet dhe fshatra.

Pushteti vendor luan një rol mjaft të rëndësishëm, si në cilësinë e shërbimeve që janë shumë afër jetës së qytetarëve, ashtu edhe si një instrument i rëndësishëm për zhvillimin ekonomik të shoqërisë në tërësi. Fokusi në procesin e reformimit të funksionimit të pushtetit vendor, por gjithashtu edhe rritjes së kapacitetit fiskal të njësisë të vetëqeverisjes vendore nëpërmjet mekanizmave të decentralizimit, kanë rritur pritshmëritë e shoqërisë ndaj shërbimeve që ofrojnë njësitë e vetëqeverisjes vendore. Pushteti vendor në Shqipëri ashtu si gjithë ekonomia në tërësi ka kaluar në disa faza zhvillimi në drejtim të cilësisë së shërbimeve direkte, që ofron për qytetarët. Krjimi i hapësirës së nevojshme fiskale dhe kapaciteteve njerëzore për zbatimin e funksioneve ligjore, është një ndër synimet bazë të forcimit të rolit të pushtetit vendor.

Decentralizimi dhe fuqizimi i qeverisjes vendore, vazhdon të mbetet një ndër prioritetet e qeverisë dhe reformat e ndërmarra deri më tani, dhe pritet të kenë impaktin më të madh në organizimin e administratës publike vendore në funksion të rritjes së cilësisë në ofrimin e shërbimeve publike vendore.



## BASHKIA KORÇË



Harta e territorit të bashkisë.



## BASHKIA KORÇË

### 2. Kuadri ligjor

- Ligji nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”;
- Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;
- Ligji nr. 9632/2006 “Për sistemin e taksave vendore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar
- Ligji nr. 9936/2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 10296/2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9869/2008 “Për huamarrjen e qeverisjes vendore;
- Udhëzimit nr. 9 datë 20.03.2018 i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar.
- Ligje dhe akte nënligjore të tjera.

### 3. Parimet themelore të financave të vetëqeverisjes vendore

1. Politikat financiare garantojnë mjaftueshmërinë financiare të njërive të vetëqeverisjes vendore dhe bazohen në parimin e shumëllojshmërisë së burimeve të të ardhurave.
2. Funkcionet dhe kompetencat që u delegohen njërive të vetëqeverisjes vendore shoqërohen kurdoherë me mjetet e nevojshme financiare për realizimin e tyre.
3. Njësitë e vetëqeverisjes vendore financohen nga të ardhurat që sigurohen nga taksat, tarifat dhe të ardhurat e tjera vendore, nga fondet e transferuara nga qeverisja qendrore dhe fondet që u vijnë drejtpërdrejt atyre nga ndarja e taksave dhe tatimeve kombëtare, huamarrja vendore, donacione, si dhe burime të tjera, të parashikuara në ligj.
4. Njërive të vetëqeverisjes vendore u garantohet me ligj e drejta për krijimin e të ardhurave në mënyrë të pavarur.
5. Çdo njësi e vetëqeverisjes vendore harton, miraton, zbaton dhe administron çdo vit buxhetin e vet, pa deficit, si dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi që rregullon administrimin e zbatimin e sistemit buxhetor dhe ligjin për financat vendore.

### 4. Buxheti vendor 2023

Reformat në qeverisjen vendore ndër vite janë fokusuar si në thellimin e decentralizimit fiskal, ashtu edhe menaxhimin e financave publike në nivel vendor. Përballimi i sfidave të mëdha ekonomike dhe buxhetore nga njësitë e vetëqeverisjes vendore gjatë kësaj periudhe, është një tregues pozitiv i punës së zhvilluar në këto vite



## BASHKIA KORÇË

në drejtim të stabilitetit makroekonomik, parashikueshmërisë së fondeve dhe transparencës së përdorimit me disiplinë të fondeve buxhetore.

Pushteti vendor luan një rol të rëndësishëm si në cilësinë e shërbimeve duke qenë afër jetës së qytetarëve ashtu edhe si një aktor i rëndësishëm për zhvillimin ekonomik të shoqërisë në tërësi. Disa prej arritjeve më të rëndësishme në proceset e menaxhimit të financave vendore janë:

- Rritja e mbështetjes së dhënë nga buxheti qendror për pushtetin vendor në formën e transfertave (transferta e pakushtëzuar dhe sektoriale).
- Përmirësimi i menaxhimit të financave vendore përmes rritjes së peshës së taksave vendore në të ardhurat vendore.
- Shpërndarja e Tatimit mbi të Ardhurat Personale duke i dhënë mundësi financiare shtesë njësive të vetëqeverisjes vendore për të amortizuar vështirësitë dhe rritur efektshmërinë e shërbimeve.
- Konsolidimi i procedurave dhe sistemi i menaxhimit të financave vendore në të gjithë etapat, që nga hartimi i programit buxhetor afatmesëm tek zbatimi dhe monitorimi i tij; harmonizimi dhe unifikimi i procedurave për hartimin, zbatimin, raportimin, monitorimin e buxheteve të njësive të vetëqeverisjes vendore, në përputhje me standardet ndërkombëtare;
- Zbatimi i metodologjisë për hartimin e programit buxhetor afatmesëm në nivel produkti buxhetor, përmes formateve të reja;
- Prezantimi dhe përdorimi i treguesve të performancës në PBA dhe ndikimi pozitiv në rritjen e cilësisë së monitorimit të zbatimit të buxhetit vendor;
- Ulja e numrit të programeve buxhetore dhe fillimi i një faze të re pilotimi për hartimin e Programit Buxhetor Afatmesëm në tre bashki.
- Monitorimi i vazhdueshëm i treguesve fiskalë të zbatimit të buxhetit, në funksion të zbatimit të politikave buxhetore që do të rrisin efikasitetin dhe efektshmërinë e përdorimit të fondeve publike në nivel vendor;
- Përgatitja dhe publikimi periodik dhe vjetor i raportit të analizës së financave publike vendore;
- Hartimi i raporteve periodike të menaxhimit të vështirësive financiare, si një detyrim ligjor për të monitoruar situatën financiare të njësive të vetëqeverisjes vendore; publikimi i raportit vjetor: “Mbi statusin e vështirësive financiare të njësive të vetëqeverisjes vendore”;
- Asistenca e drejtpërdrejtë ndaj njësive të vetëqeverisjes vendore, në të gjitha hapat e menaxhimit financiar në nivel vendor përmes komenteve dhe konsultimit jo vetëm të hartimit të programit buxhetor afatmesëm, por edhe të raportit të monitorimit të zbatimit të buxhetit;



## BASHKIA KORÇË

- Realizimi i trajnimeve, takimeve dhe konsultimeve të vazhdueshme me njësitë e vetëqeverisjes vendore në kuadër të masave të marra nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë për menaxhimin financiar në nivel vendor, si një hap parapërgatitor për zbatimin e sistemit AFMIS në nivel vendor në një periudhë afatmesme.

### **5. Buxhetimi gjinor**

Të sigurojë që në krijimin dhe shpërndarjen e burimeve financiare vendore të njësive të vetëqeverisjes vendore të përshpejtohet dhe realizohet barazia gjinore. Të paktën një nga objektivat e politikave të programeve duhet të adresojë problematika të pabarazisë gjinore ose respektimin e plotë të barazisë gjinore, duke identifikuar qartazi produktet dhe treguesit e tjerë të matshëm me bazë gjinore;

Barazia gjinore, që i referohet gjendjes së burrave dhe grave që kanë mundësi dhe akses të barabartë në të njëjtat të drejta dhe përfitime.

Në buxhetin e vitit 2023 janë planifikuar projekte të cilat përfshijnë:

- marrjen në konsideratë të nevojave të ndryshme të grave dhe burrave.
- aktivitete me fokus gratë, fëmijët dhe të moshuarit

### **6. Të ardhurat e veta të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore**

Njësitë e vetëqeverisjes vendore financohen nga të ardhurat që sigurohen nga taksat, tarifat dhe të ardhurat e tjera vendore, nga fondet e transferuara nga Buxheti i Shtetit dhe fondet që u vijnë drejtpërdrejt nga ndarja e taksave e tatimeve kombëtare, huamarrja vendore, donacionet, si dhe burime të tjera të parashikuara në ligj.

#### **6.1. Të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore**

Planifikimi i të ardhurave nga taksat/tarifatat është mbështetur në paketën fiskale të Bashkisë Korçë, e cila përcakton llojet e taksave, bazën e taksueshme, kategorizimet dhe nënkategorizimet, këstet e pagimit, kohën e kryerjes së tyre, efektet e lehtësive, strukturat përgjegjëse për vjeljen e detyrimeve dhe agjentët tatimorë. Ndër prioritetet e punës sonë është edhe rritja e performancës, rritja e aftësive për të shtuar të ardhurat, disiplina financiare, sigurimi i burimeve të reja të të ardhurave, përgjegjshmëria më e lartë në raport me qytetarët dhe maksimizimi i përpjekjeve për të digjitalizuar shërbimet që ofrohen për qytetarët.

Bazuar :

- Në nivelet e aplikueshme të taksave dhe tarifave vendore të miratuara si në legjislacionin tatimor në fuqi ashtu dhe në vendimet përkatëse të Këshillit të Bashkisë Korçë.



## BASHKIA KORÇË

- Në realizimet faktike të të ardhurave për vitin 2020, vitin 2021 dhe realizimin 11 muajor të vitit 2022.
- Në përlogaritjet e kapaciteteve reale të taksave dhe tarifave nëpërmjet zgjerimit të bazës së taksapaguesve dhe saktësisht të të dhënave.
- Në parashikimin e mbledhjes së detyrimeve debitoare, referuar legjislacionit në fuqi.
- Në parashikimin e të ardhurave që mblidhen nga agjentët tatimorë.
- Në parashikimin e të ardhurave që mblidhen nga drejtoritë dhe institucionet e Bashkisë.
- Në ecurinë e realizimit të të ardhurave për çdo taksë dhe tarifë si dhe duke analizuar faktorët që kanë ndikuar në rritjen ose pakësimin e arkëtimeve.
- Në forcimin e kapaciteteve administruese.
- Në lehtësimin e procedurave dhe përmirësimin e klimës së marrëdhënieve me taksapaguesit.

Procesi i planifikimit të të ardhurave të veta u realizua në bashkëpunim me administratën e Bashkisë, me Njësitë Administrative, me Institucionet e Agjentët tatimorë, etj. Vazhdimi i këtij procesi bashkëpunues do të mundësojë sigurimin e të ardhurave, me efekt përmirësimin e mëtejshëm të shërbimeve që ofron bashkia ndaj qytetarëve të saj, duke realizuar objektivat madhorë në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm në të gjithë territorin e bashkisë.

Në mënyrë të detajuar po paraqesim realizimin e vitit 2020, realizimin e vitit 2021, realizimin 11 muajor të vitit 2022 planifikimin e vitit 2022, realizimin e pritshëm për vitin 2022 si dhe planifikimin për vitin 2023 në lidhje me taksat dhe tarifatat vendore në Bashkinë e Korçës.

A	TË ARDHURA NGA TAKSAT VENDORE	Realizim 2020	Realizim 2021	Plani 2022	Realiz. 11 muaj 2022	I pritshëm 2022	Plani 2023
1	TAKSË MBI NDËRTESEN	93,163,646	114,846,019	185,165,510	110,125,538	121,216,363	197,673,192
2	TAKSË MBI TRUALLIN	8,593,312	12,601,210	24,269,491	11,190,830	12,491,589	23,414,724
3	TAKSË MBI TOKËN BUJQËSORE	18,175,238	20,386,785	59,883,370	16,503,209	20,800,686	65,886,435
4	TATIM FITIMI I THJESHTUAR PËR BIZNESIN E VOGËL	5,252,764	6,174,696	5,473,380	1,126,960	1,169,931	3,500,000
5	TAKSË PËR NDËRTIMET E REJA	44,228,451	134,234,446	146,000,000	66,484,574	73,082,715	222,000,000
6	TAKSË NDIKIMI NË INFRASTRUKURË NGA LEGALIZIMET	4,759,866	5,429,441	60,425,066	12,765,179	13,068,957	49,939,000
7	TAKSË FJETJE NË HOTEL	3,943,070	5,956,660	6,500,000	6,922,648	7,495,108	8,000,000
8	TAKSË TABELLE	7,441,310	7,920,852	7,640,375	7,379,734	7,650,579	8,429,000
	<b>TOTAL A</b>	<b>185,557,657</b>	<b>307,550,109</b>	<b>495,357,192</b>	<b>232,498,672</b>	<b>256,975,928</b>	<b>578,842,351</b>
B	TË ARDHURA JO TATIMORE						



### BASHKIA KORÇË

1	TARIFË PASTRIMI	148,508,366	160,894,253	198,227,000	144,386,513	155,830,855	225,945,805
2	TARIFË NDRICIMI	32,906,154	35,364,905	45,020,170	32,623,992	35,098,801	51,258,028
3	TARIFË GJELBËRIMI	21,733,830	23,731,605	28,767,070	21,285,041	22,788,883	32,143,581
4	TARIFË MIRËMBAJTJE VARREZA PUBLIKE	11,969,607	12,809,101	18,301,350	11,256,741	12,589,142	22,332,353
5	TARIFË ZËNIE HAPËSIRE PUBLIKE	13,028,689	20,993,471	28,530,019	19,841,779	21,188,171	27,265,930
6	TARIFË REGJISTRIMI PËR LEJE TRANSPORTI	945,430	1,105,340	1,070,000	948,865	973,935	1,300,000
7	TARIFË MUR PERIMETRAL	650,320	1,458,255	1,500,000	499,638	544,038	1,500,000
8	TARIFË PARKIMI	13,915,718	20,566,853	21,548,520	18,051,018	19,897,388	22,000,000
9	TE ARDHURA TE TJERA	26,697,758	10,233,162	5,945,000	8,882,692	13,278,609	5,000,000
10	ÇERTIFIKATË PËR MBROJTJEN NGA ZJARRI	415,000	523,250	322,000	270,000	307,000	350,000
11	MIRATIM PROJEKTI	375,500	595,000	460,000	570,000	590,000	500,000
12	SHËRBIME ZJARRFIKSE NË OBJEKTE TË SIGURUARA	0	0	10,000	0	0	10,000
13	SHËRBIME ZJARRFIKSE NDAJ TE TRETJEVE	0	0	40,000	0	0	40,000
14	MARRJE ME QERA PYLLI+ QERA PER KULLOTA	5,940,844	3,816,355	8,000,000	7,285,333	7,246,903	8,990,000
15	TË ARDHURA NGA SHITJA E DRUVE TË ZJARRIT	2,709,640	1,600,000	2,500,000	2,346,060	2,346,060	3,000,000
16	VËRTETIME TRANSPORTI	81,000	66,000	51,000	48,000	48,000	60,000
17	SHITJE DOKUMENTA ANKANDI	2,000	0	3,000	0	0	0
18	PRODHIMET E DYTA MIDICINALE	0	0	500,000	0	0	1,000,000
19	GJOBA POLICIA BASHKIAKE	911,000	688,000	2,200,000	304,000	444,000	1,000,000
20	GJOBA PËR VONESE NË PAGESE	5,507,599	6,857,732	7,900,000	4,349,077	5,409,360	6,000,000
21	GJOBA INSPEKTORIATI I NDËRTIMIT	706,000	2,041,716	2,000,000	1,948,858	2,001,858	2,500,000
22	GJOBA TË DREJTORISË SË KONTROLLIT TË TERRITORIT	140,000	75,000	100,000	15,000	20,000	200,000
23	GJOBA TË D.T.T.V	40,000	120,000	360,000	20,000	60,000	200,000
24	QIRA OBJEKTI, QERA TRUALLI, QERA T.BUJQËSORE	7,338,834	8,860,957	20,132,390	7,767,359	9,587,993	9,500,000
25	TARIFË VENDORE PËR SHQYRTIM LEJE ZHVILLIMI	405,000	555,000	450,000	485,000	520,000	500,000
26	TARIFE PËR LEJE NDËRTIMI	220,500	340,000	280,000	258,500	267,500	380,000
27	TARIFË SERVITUTI	828,072	618,740	1,195,523	656,315	667,799	1,500,000
28	TË ARDHURA NGA QIRATË, BANESA SOCIALE (CEB)	6,188,186	6,917,333	6,860,000	6,253,212	6,775,438	7,044,000



### BASHKIA KORÇË

29	TË ARDHURA NGA BANESA SHTETËRORE	0	0	0	0	0	72,000
30	QIRA NGA BANESAT NË PRONËSI TË BASHKISË E.K.B + PRIVATIZIMI I BANESAVE	2,222,447	1,352,353	5,230,000	13,301,469	14,423,888	2,834,000
31	KAMATË VONESA(QIRA OBJEKTI)	129,954	230,043	100,000	434,107	457,810	500,000
32	TARIFË PËR DEPOZITIMIN E MBETJEVE INERTE	0	0	2,760,000	1,040,814	1,040,814	2,800,000
33	TARIFË VJETORE E SHËRBIMIT DHE MIRËMBAJTJES TË RRUGËVE TË PARCELAVE DHE TË SITEMIT KULLUES	6,121,748	9,930,685	36,472,330	7,174,357	9,484,422	36,567,952
<b>TOTAL B</b>		<b>310,639,195</b>	<b>332,345,109</b>	<b>446,835,372</b>	<b>312,303,739</b>	<b>343,888,666</b>	<b>474,293,649</b>
<b>TË ARDHURA NGA TAKSAT E NDARA</b>							
1	TATIM SHITJEJE PASURI E PALUAJTSHME	2,906,783	22,932,304	26,605,945	14,702,883	15,855,980	25,000,000
2	TAKSË RREGJISTRIMI E PËRVITSHME (AUTOMJETE)	38,618,245	43,262,884	40,028,515	39,725,322	43,784,797	47,000,000
3	DIVIDENTI NGA UKKO	661,319	647,175	5,000,000	2,801,366	2,801,366	2,000,000
4	DIVIDENTI NGA KRWM	0	0	0	3,257,727	0	400,000
5	RENTA MINERARE	395,906	331,454	236,100	425,591	533,381	700,000
6	TATIMI MBI TË ARDHURAT PERSONALE	16,719,227	22,090,739	24,000,000	18,768,161	33,683,692	35,000,000
<b>TOTALI C</b>		<b>59,301,480</b>	<b>89,264,556</b>	<b>95,870,560</b>	<b>79,681,050</b>	<b>96,659,216</b>	<b>110,100,000</b>
<b>TOTAL A+B+C</b>		<b>555,498,333</b>	<b>729,159,774</b>	<b>1,038,063,124</b>	<b>624,483,461</b>	<b>697,523,810</b>	<b>1,163,236,000</b>

### Paraqitja grafike



### TAKSAT VENDORE


A	TË ARDHURA NGA TAKSAT	Realizim	Realizim	Plani 2022	Realiz. 11 muaj	I pritshëm	Plani 2023
---	-----------------------	----------	----------	------------	-----------------	------------	------------



## BASHKIA KORÇË

	VENDORE	2020	2021		2022	2022	
1	TAKSË MBI NDËRTESEN	93,163,646	114,846,019	185,165,510	110,125,538	121,216,363	197,673,192
2	TAKSË MBI TRUALLIN	8,593,312	12,601,210	24,269,491	11,190,830	12,491,589	23,414,724
3	TAKSË MBI TOKËN BUJQËSORE	18,175,238	20,386,785	59,883,370	16,503,209	20,800,686	65,886,435
4	TATIM FITIMI I THJESHUAR PËR BIZNESIN E VOGËL	5,252,764	6,174,696	5,473,380	1,126,960	1,169,931	3,500,000
5	TAKSË PËR NDËRTIMET E REJA	44,228,451	134,234,446	146,000,000	66,484,574	73,082,715	222,000,000
6	TAKSË NDIKIMI NË INFRASTRUKURË NGA LEGALIZIMET	4,759,866	5,429,441	60,425,066	12,765,179	13,068,957	49,939,000
7	TAKSË FJETJE NË HOTEL	3,943,070	5,956,660	6,500,000	6,922,648	7,495,108	8,000,000
8	TAKSË TABELE	7,441,310	7,920,852	7,640,375	7,379,734	7,650,579	8,429,000
	<b>TOTALI</b>	<b>185,557,657</b>	<b>307,550,109</b>	<b>495,357,192</b>	<b>232,498,672</b>	<b>256,975,928</b>	<b>578,842,351</b>

### Paraqitja grafike



**Taksat vendore zenë 49.8 % të totalit të të ardhurave që planifikohen të arkëtohen gjatë vitit 2023. Taksat me peshën më të madhe janë:**

- **Taksa mbi ndërtesën zë 17% të totalit të të ardhurave që planifikohen dhe 34.1% të totalit të të ardhurave të parashikuara nga taksat vendore.**
- **Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja zë 19.1% të totalit të të ardhurave që planifikohen dhe 38.3% të totalit të të ardhurave të parashikuara nga taksat vendore.**



## BASHKIA KORÇË

- **Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet zë 4.3% të totalit të të ardhurave që planifikohen dhe 8.6% të totalit të të ardhurave të parashikuara nga taksat vendore.**
- **Taksa mbi tokën bujqësore zë 5.7% të totalit të të ardhurave që planifikohen dhe 11.4% të totalit të të ardhurave të parashikuara nga taksat vendore.**

Më konkretisht po i detajojmë më poshtë:

### 1.TAKSA MBI NDËRTESËN

Parashikimi për vitin 2023 është i bazuar tek zgjerimi i bazës së taksueshme dhe bazës së taksapaguesve nëpërmjet:

- Saktësimi dhe vlerësimi të drejtë të sipërfaqeve
- Verifikimi në terren si dhe vlerësimi në lidhje me vlerën e pronave
- Mbështetjes së agjentëve tatimorë
- Plotpjestimi me këste i taksës së ndërtesës gjatë gjithë vitit ushtrimor për taksapaguesit familjarë
- Zgjerimi i numrit të taksapaguesve falë politikave lehtësuese, rivlerësimi të gjëndjes faktike, përmirësimit të marrëdhënieve dhe shërbimit me taksapaguesit si dhe bashkëpunimit me A.SH.K.

Taksa mbi ndërtesën për vitin 2023 planifikohet të jetë në vlerën **197,673,192 lekë** dhe zë **17 %** të planifikimit total për vitin 2023.

Bazuar në informacionin dhe regjistrat që ne disponojmë planifikohen të përfshihen në skemën e detyrimit për këtë taksë **35,175 njësi pronësore me sipërfaqe të përgjithshme prej 4,140,059.71 m<sup>2</sup>** në vlerën **131,593,858 lekë**, njësi pronësore këto që shfrytëzohen për banim, nga subjektet e biznesit të vogël, nga subjektet e biznesit të madh, O.J.F apo njësi në pronësi të individëve të destinuar për veprimtari social-ekonomike të cilët nuk i kanë vënë në shfrytëzim:

- Nga familjarët e Bashkisë Korçë planifikohet të arkëtohet në vlerën **68,811,162 lekë** nga **30,513 njësi pronësore që taksohen për banim me sipërfaqe 3,838,951 m<sup>2</sup>**, konkretisht:
- 20,045 njësi pronësore me sipërfaqe 2,721,090 m<sup>2</sup> të destinuar për banim në vlerën **53,322,280 lekë** në njësinë administrative Korçë.
- 10,468 njësi pronësore me sipërfaqe 1,117,861 m<sup>2</sup> të destinuar për banim në vlerën **15,488,882 lekë** në njësitë e tjera administrative të Bashkisë Korçë.
- Në njësinë administrative Korçë planifikohet të arkëtohet në vlerën **50,543,862 lekë**, për 4,190 njësi pronësore për qëllime biznesi me sipërfaqe 568,796.99 m<sup>2</sup> detajohet si më poshtë:
- 2,611 njësi pronësore me sipërfaqe 250,885.86 m<sup>2</sup> të destinuar për tregëti dhe shërbime në vlerën **34,471,717 lekë**.
- 60 njësi pronësore me sipërfaqe 65,311.05 m<sup>2</sup> të destinuar për prodhim në vlerën **2,991,246 lekë**.



## BASHKIA KORÇË

- 1,279 njësi pronësore me sipërfaqe 231,039.29 m<sup>2</sup> të destinuar për magazina si dhe objekte në të cilat nuk ushtrohet aktivitet në vlerën **10,581,599 lekë**.
- 240 njësi pronësore me sipërfaqe 21,560.79 m<sup>2</sup> të destinuar për bodrume, garazhd dhe parking të mbuluar në pronësi të subjekteve të biznesit apo në pronësi të individëve me vlerë **2,449,300 lekë**.
  - Në njësitë e tjera administrative të Bashkisë Korçë planifikohet të arkëtohet në vlerën **12,238,834 lekë**, për 472 njësi pronësore për qëllime biznesi me sipërfaqe 182,310.72 m<sup>2</sup> detajohet si më poshtë:
- 392 njësi pronësore me sipërfaqe 102,854.01 m<sup>2</sup> të destinuar për tregëti dhe shërbime në vlerën **9,205,434 lekë**.
- 68 njësi pronësore me sipërfaqe 64,724.61 m<sup>2</sup> të destinuar për prodhim në vlerën **2,769,695 lekë**.
- 12 njësi pronësore me sipërfaqe 14,732.10 m<sup>2</sup> të destinuar për blegtori në vlerën **263,705 lekë**

Nga debitorët planifikohet të arkëtohet në vlerën **66,129,334 lekë** :

- Nga debitorët familjarë në njësinë administrative Korçë në vlerën **16,189,487 lekë**
- Nga debitorët familjarë në njësitë e tjera administrative të Bashkisë Korçë në vlerën **15,799,248 lekë**.
- Nga debitorët e subjekteve të biznesit apo individëve të cilët zotërojnë njësi pronësore të destinuar për aktivitet social-ekonomik si dhe nga njësitë pronësore në të cilat nuk ushtrohet aktivitet, në vlerën **34,140,599 lekë**.

Theksojmë këtu se ndikim negativ në këtë planifikim kanë pasur lehtësitë fiskale të ndërmara nga Bashkia Korçë. Për vitin 2022 janë përjashtuar 5,858 familje me njësi pronësore për banim me sipërfaqe totale 481,130 m<sup>2</sup>, konkretisht në njësinë administrative Korçë 4,738 familje me njësi pronësore me sipërfaqe totale për banim 402,730 m<sup>2</sup> në vlerën **9,262,790 lekë** dhe 1,120 familje me njësi pronësore me sipërfaqe totale për banim 78,400 m<sup>2</sup> në njësitë e tjera administrative me vlerë **1,176,000 lekë**.

Strukturat përgjegjëse për arkëtimin e kësaj takse janë Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, Njësitë Administrative të Bashkisë Korçë dhe agjenti tatimor U.K.KO. Sha.

## 2. TAKSA MBI TRUALLIN

Parashikimi për vitin 2023 është i bazuar tek zgjerimi i bazës së taksueshme dhe bazës së taksapaguesve nëpërmjet:

- Saktësimin dhe vlerësimin të drejtë të sipërfaqeve.
- Kategorizimit sipas qëllimit të përdorimit.
- Zgjerimi i numrit të taksapaguesve, rivlerësimin të gjëndjes faktike, përmirësimin të marrëdhënieve dhe shërbimit me taksapaguesit si dhe bashkëpunimit me A.SH.K.

Taksa mbi truallin për vitin 2023 planifikohet të jetë në vlerën **23,414,724 lekë** dhe zë **2.01 %** të planifikimit total për vitin 2023 dhe **4%** të totalit të të ardhurave të parashikuara nga taksat vendore. Kjo taksë planifikohet të arkëtohet:



## BASHKIA KORÇË

- Nga subjektet e biznesit në Bashkinë Korçë planifikohen të arkëtohen nga 553 njësi pronësore me sipërfaqe 607,225.86 m<sup>2</sup> në vlerën **10,930,065 lekë**.
- Nga familjarët e Bashkisë Korçë planifikohen të arkëtohen nga 19,751 njësi pronësore me sipërfaqe 8,035,462 m<sup>2</sup> në vlerën **3,374,894 lekë**.
- Nga debitorët e biznesit në vlerën **6,977,406 lekë**.
- Nga debitorët familjarë në vlerën **2,132,359 lekë**.

Strukturat përgjegjëse për arkëtimin e kësaj takse janë, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, Njësitë Administrative të Bashkisë Korçë dhe agjenti tatimor U.K.KO Sha.

### 3.TAKSA MBI TOKËN BUJQËSORE

Parashikimi për vitin 2023 është i bazuar tek zgjerimi i bazës së taksueshme dhe bazës së taksapaguesve nëpërmjet:

- Saktësimin dhe vlerësimin të drejtë të sipërfaqeve
- Verifikimit në terren
- Zgjerimi i numrit të taksapaguesve, rivlerësimin të gjëndjes faktike, përmirësimin të marrëdhënieve dhe shërbimit me taksapaguesit si dhe bashkëpunimit me A.SH.K

Taksa mbi tokën bujqësore për vitin 2023 është planifikuar **65,886,435 lekë** me një sipërfaqe prej 12,385.1 ha (informacion i disponuar nga Drejtoria e Bujqësisë dhe Pyjeve) dhe zë **5.7 %** të planifikimit total për vitin 2023 dhe **11.4%** të totalit të të ardhurave të parashikuara nga taksat vendore, konkretisht të detajuara po i paraqesim në tabelat e mëposhtme:

Nr	Njësia administrative	Sip / hektar	Vlera / lekë
1	Njësia administrative Korçë	389.00	793,133
2	Njësia administrative Bulgarec	3,738.40	7,213,572
3	Njësia administrative Drenovë	2,088.00	4,487,800
4	Njësia administrative Mollaj	1,808.00	4,158,400
5	Njësia administrative Vithkuq	1,250.00	1,938,900
6	Njësia administrative Voskop	2,310.00	4,652,200
7	Njësia administrative Voskopojë	485.00	679,000
8	Njësia administrative Lekas	317.00	443,800
	<b>Totali</b>	<b>12,385.1</b>	<b>24,366,805</b>

Kategoria e tokës (Boniteti)	Sipërfaqja/ha	Çmimi në lekë/ha/vit	Vlera/ lekë
Kategoria III	12.7	2800	35,504
Kategoria IV	5156.3	2300	11,859,454
Kategoria V	3948.0	1900	7,501,219
Kategoria VI	1976.3	1600	3,162,080



## BASHKIA KORÇË

Kategoria VII-X	1291.8	1400	1,808,548
<b>Totali</b>	<b>12,385.1</b>		<b>24,366,805</b>

Konkretisht për vitin 2023 planifikohen të arkëtohen:

- Nga 12,385.1 ha vlera prej **24,366,805 lekë** detyrim ky i vitit 2023
- Nga debitorët, vlera e të cilëve përlllogaritet në masën **41,519,630 lekë**, debi kjo e përlllogaritur për pronarët apo poseduesit e tokës bujqësore të cilët nuk e kanë paguar këtë taksë për vitin 2022 dhe për periudhën paraardhëse.

### 4.TATIM I THJESHTUAR MBI FITIMIN PËR BIZNESIN E VOGËL

Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël për vitin 2023 parashikohet të jetë **3,500,000 lekë** parashikim ky i bërë nga të dhënat e mara nga Drejtoria Rajonale Tatimore Korçë.

### 5.TAKSA E NDIKIMIT NË INFRASTRUKTURË NGA NDËRTIMET E REJA

Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja për vitin 2023 planifikohet në vlerën **222,000,000 lekë** parashikim ky i bërë nga Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit.

Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja zë 19.1% të totalit të të ardhurave që planifikohen dhe 38.3% të totalit të të ardhurave të parashikuara nga taksat vendore.

### 6. TAKSA E NDIKIMIT NË INFRASTRUKTURË NGA LEGALIZIMET

Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet për vitin 2023 planifikohet në vlerën **49,939,000 lekë** parashikim ky i bërë nga të dhënat e disponuara nga Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit si dhe duke marrë parasysh realizimin e vitit 2022. Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet zë 4.3% të totalit të të ardhurave që planifikohen dhe 8.6% të totalit të të ardhurave të parashikuara nga taksat vendore.

### 7.TAKSA E FJETJES NË HOTEL

Planifikimi i të ardhurave për vitin 2023 i taksës së fjetjes në hotel është bërë duke u bazuar në numrin e njësive që japin strehim kundrejt pagesës dhe përfshin emërtimet hotel, motel, stabiliment turistik, pension, shtëpi pritjeje, turizëm familjar dhe çdo objekt tjetër që përdoret për këtë qëllim si dhe kapacitet akomoduese të tyre. Kjo taksë për vitin 2023 planifikohet në vlerën **8,000,000 lekë** nga 125 subjekte (Bujtina/ Hotele) të detajuara si më poshtë:

- 41 bujtina me kapacitet akomodues 590 persona
- 84 hotele me kapacitet akomodues 2581 persona

Gjithashtu pritet që gjatë vitit 2023 të hyjnë në funksionim 3 bujtina dhe 8 hotele të cilët aktualisht janë duke investuar në këtë fushë. Arkëtim gjatë vitit 2023 do të ketë dhe nga ato subjekte të cilat nuk do ta paguajnë këtë taksë brenda vitit 2022 për vetë faktin se taksën e fjetjes në hotel për muajin dhjetor subjektet e paguajnë brenda datës 5 Janar të vitit 2023, gjithashtu dhe nga ato subjekte që nuk kanë paguar brenda afatit të



## BASHKIA KORÇË

përcaktuar këstet mujore të vitit 2022 apo dhe debitorë të viteve të mëparëshme të cilat do të jenë objekt i masave shtrënguese konform legjislacionit në fuqi.

### 8.TAKSA E TABELËS

Taksa e tabelës aplikohet për tre lloje tabelash, të përcaktuara sipas qëllimit të përdorimit dhe mënyrës së vendosjes së tyre:

**-Tabela për qëllime identifikimi**, mbi 2 metra katror, të trupëzuara në sipërfaqen e ndërtesës ose brenda territorit ku zhvillon aktivitet biznesi dhe që nuk përdoren për të reklamuar aktivitetin e të tretëve. Në të tilla tabela vendoset emri dhe/ose lloji i aktivitetit të kompanisë. Tabelat me sipërfaqe më të vogël se 2 m<sup>2</sup> nuk taksohen.

**-Tabela për qëllime reklamimi**, ku përfshihen tabelat që nuk janë brenda territorit të biznesit ose nuk janë të trupëzuara në sipërfaqen e ndërtesës, dhe që mund të jenë të thjeshta ose elektronike dhe që përdoren për të reklamuar aktivitetin e të tretëve .

**-Tabela për qëllime ekspozimi**, ku përfshihen tabelat me karakter të përkohshëm, për ekspozime të ndryshme të hapura, panaire, spektakle, stenda reklamuese, banderola, etj.

Taksa e tabelës për vitin 2023 është planifikuar në vlerën **8,429,000 lekë**, parashikim ky nga Drejtoria e Kontrollit të Territorit i cili bazohet në administrimin dhe pasurimin e të dhënave për numrin e subjekteve që kanë vendosur tabelë identifikuese për orientim, numrin e subjekteve që kanë vendosur tabelë identifikuese mbi 2 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqen e tyre si dhe numrin e subjekteve që kanë vendosur tabelë reklamuese, sipërfaqen e tyre të ndodhura në Bashkinë Korçë dhe debitorë deri në këto momente.

Në lekë

Taksa e Tabelës					
Nr		Nr.subjekte	Sipërfaqja m <sup>2</sup>	Vleftha/njësi	TOTAL
1	Tabelë e thjeshtë	43	240.64	22,500	5,414,400
2	Tabelë e thjeshtë (mbi 2 m <sup>2</sup> )	7	33.14	10,000	331,400
3	Tabelë me ndriçim (mbi 2 m <sup>2</sup> )	37	165.11	15,000	2,476,650
4	Debitorë	2	13.77	15,000	206,550
					<b>8,429,000</b>

### TARIFAT VENDORE

B	TË ARDHURA JO TATIMORE	Realizim 2020	Realizim 2021	Plani 2022	Realiz. I muaj 2022	I priturshëm 2022	Plani 2023
1	TARIFË PASTRIMI	148,508,366	160,894,253	198,227,000	144,386,513	155,830,855	225,945,805
2	TARIFË NDRIÇIMI	32,906,154	35,364,905	45,020,170	32,623,992	35,098,801	51,258,028
3	TARIFË GJELBËRIMI	21,733,830	23,731,605	28,767,070	21,285,041	22,788,883	32,143,581
4	TARIFË MIRËMBAJTJE VARREZA PUBLIKE	11,969,607	12,809,101	18,301,350	11,256,741	12,589,142	22,332,353
5	TARIFË ZËNIE HAPËSIRE PUBLIKE	13,028,689	20,993,471	28,530,019	19,841,779	21,188,171	27,265,930
6	TARIFË REGJISTRIMI PËR	945,430	1,105,340	1,070,000	948,865	973,935	1,300,000



## BASHKIA KORÇË


	LEJE TRANSPORTI						
7	TARIFË MUR PERIMETRAL	650,320	1,458,255	1,500,000	499,638	544,038	1,500,000
8	TARIFË PARKIMI	13,915,718	20,566,853	21,548,520	18,051,018	19,897,388	22,000,000
9	TE ARDHURA TE TJERA	26,697,758	10,233,162	5,945,000	8,882,692	13,278,609	5,000,000
10	ÇERTIFIKATË PËR MBROJTJEN NGA ZJARRI	415,000	523,250	322,000	270,000	307,000	350,000
11	MIRATIM PROJEKTI	375,500	595,000	460,000	570,000	590,000	500,000
12	SHËRBIME ZJARRFIKSE NË OBJEKTE TË SIGURUARA	0	0	10,000	0	0	10,000
13	SHËRBIME ZJARRFIKSE NDAJ TE TRETEVE	0	0	40,000	0	0	40,000
14	MARRJE ME QERA PYLLI+ QERA PER KULLOTA	5,940,844	3,816,355	8,000,000	7,285,333	7,246,903	8,990,000
15	TË ARDHURA NGA SHITJA E DRUVE TË ZJARRIT	2,709,640	1,600,000	2,500,000	2,346,060	2,346,060	3,000,000
16	VËRTETIME TRANSPORTI	81,000	66,000	51,000	48,000	48,000	60,000
17	SHITJE DOKUMENTA ANKANDI	2,000	0	3,000	0	0	0
18	PRODHIMET E DYTA MIDICINALE	0	0	500,000	0	0	1,000,000
19	GJOBA POLICIA BASHKIAKE	911,000	688,000	2,200,000	304,000	444,000	1,000,000
20	GJOBA PËR VONESË NË PAGESË	5,507,599	6,857,732	7,900,000	4,349,077	5,409,360	6,000,000
21	GJOBA INSPEKTORIATI I NDËRTIMIT	706,000	2,041,716	2,000,000	1,948,858	2,001,858	2,500,000
22	GJOBA TË DREJTORISË SË KONTROLLIT TË TERRITORIT	140,000	75,000	100,000	15,000	20,000	200,000
23	GJOBA TË D.T.T.V	40,000	120,000	360,000	20,000	60,000	200,000
24	QIRA OBJEKTI, QERA TRUALLI, QERA T.BUJQËSORE	7,338,834	8,860,957	20,132,390	7,767,359	9,587,993	9,500,000
25	TARIFË VENDORE PËR SHQYRTIM LEJE ZHVILLIMI	405,000	555,000	450,000	485,000	520,000	500,000
26	TARIFE PËR LEJE NDËRTIMI	220,500	340,000	280,000	258,500	267,500	380,000
27	TARIFË SERVITUTI	828,072	618,740	1,195,523	656,315	667,799	1,500,000
28	TË ARDHURA NGA QIRATË, BANESA SOCIALE (CEB)	6,188,186	6,917,333	6,860,000	6,253,212	6,775,438	7,044,000
29	TË ARDHURA NGA BANESA SHTETËRORE	0	0	0	0	0	72,000
30	QIRA NGA BANESAT NË PRONËSI TË BASHKISË E.K.B + PRIVATIZIMI I BANESAVE	2,222,447	1,352,353	5,230,000	13,301,469	14,423,888	2,834,000
31	KAMATË VONESA (QIRA OBJEKTI)	129,954	230,043	100,000	434,107	457,810	500,000
32	TARIFË PËR DEPOZITIMIN E MBETJEVE INERTE	0	0	2,760,000	1,040,814	1,040,814	2,800,000



## BASHKIA KORÇË

33	TARIFË VJETORE E SHËRBIMIT DHE MIRËMBAJTJES TË RRUGËVE TË PARCELAVE DHE TË SITEMIT KULLUES	6,121,748	9,930,685	36,472,330	7,174,357	9,484,422	36,567,952
<b>TOTALI</b>		<b>310,639,195</b>	<b>332,345,109</b>	<b>446,835,372</b>	<b>312,303,739</b>	<b>343,888,666</b>	<b>474,293,649</b>

### Paraqitja grafike



**Tarifat vendore zenë 40.8 % të totalit të të ardhurave që planifikohen të arkëtohen gjatë vitit 2023.**

**Tarifat me peshën më të madhe janë:**

- **Tarifa e pastrimit zë 19.4% të totalit të taksave dhe tarifave vendore që planifikohen dhe 47.7% të totalit të të ardhurave të parashikuara nga tarifat vendore.**
- **Tarifa e ndriçimit zë 4.4% të totalit të taksave dhe tarifave vendore që planifikohen dhe 10.8% të totalit të të ardhurave të parashikuara nga tarifat vendore.**
- **Tarifa e gjelbërimit zë 2.8% të totalit të taksave dhe tarifave vendore që planifikohen dhe 6.8% të totalit të të ardhurave të parashikuara nga tarifat vendore.**
- **Tarifë vjetore e shërbimit dhe mirëmbajtjes të rrugëve të parcelave dhe të sitemit kullues zë 3.1% të totalit të taksave dhe tarifave vendore që planifikohen dhe 7.7% të totalit të të ardhurave të parashikuara nga tarifat vendore.**
- **Tarifa për zënien e hapësirave publike zë 2.3% të totalit të taksave dhe tarifave vendore që planifikohen dhe 5.7% të totalit të të ardhurave të parashikuara nga tarifat vendore.**
- **Tarifa e parkimit zë 1.9% të totalit të taksave dhe tarifave vendore që planifikohen dhe 4.6% të totalit të të ardhurave të parashikuara nga tarifat vendore.**
- **Tarifë mirëmbajtje varreza publike zë 1.9% të totalit të taksave dhe tarifave vendore që planifikohen dhe 4.7% të totalit të të ardhurave të parashikuara nga tarifat vendore.**

**Më konkretisht po i detajojmë më poshtë:**



## BASHKIA KORÇË

### 1. TARIFA E PASTRIMIT

Parashikimi për vitin 2023 është i bazuar tek zgjerimi i bazës së taksueshme nëpërmjet:

- Përditësimit dhe përmirësimit të të dhënave të sistemit të taksave dhe tarifave vendore
- Verifikimit në terren nga administrata e rajoneve dhe njësive administrative për familjet efektive
- Verifikimit në terren nga inspektorët e D.T.T.V në lidhje me subjektet që ushtrojnë aktivitet
- Bashkëpunimit dhe shkëmbimit të informacionit me Q.K.B, D.R.T, U.K.KO dhe Zyrën e Gjëndjes Civile në lidhje me nr e subjekteve dhe familjeve të regjistruara në Bashkinë Korçë

Tarifa e pastrimit planifikohet në vlerën **225,945,805 lekë** dhe zë **19.4 %** të totalit të taksave dhe tarifave vendore që planifikohen për vitin 2023 dhe **47.7%** të totalit të të ardhurave të parashikuara nga tarifat vendore.

Kjo tarifë planifikohet të arkëtohet nga:

- 2,621 subjekte të biznesit të vogël në vlerën **26,623,950 lekë**
- 694 subjekte të biznesit të madh në vlerën **38,587,000 lekë**
- 81 institucione shtetërore dhe ojf në vlerën **2,112,000 lekë**
- subjektet ndërtuese për kantieret e ndërtimit referuar numrit të lejeve të dhëna gjatë vitit 2022 në vlerën **3,400,000 lekë**
- 21,978 familje rezidente efektive të njësisë administrative Korçë në vlerën **83,516,400 lekë**
- 7,657 familje rezidente efektive të njësive administrative të tjera të Bashkisë Korçë në vlerën **11,389,500 lekë**
- debitorët familjarë në vlerën **44,094,375 lekë**
- debitorët e subjekteve të biznesit parashikohet në vlerën **16,222,580 lekë**.

Në planifikimin e tarifës së pastrimit ndikim negativ kanë dhe lehtësitë fiskale apo përjashtimet në pagesën e kësaj tarife.

Për vitin 2023 vlera prej **12,435,400 lekë** do ti mungojë buxhetit të Bashkisë por do jetë në buxhetet e familjeve dhe sipërmarrjeve private.

1. Subjekte të cilat përfitojnë 20% ulje të tarifës së pastrimit, referuar të dhënave paraprake që disponojmë janë 51 subjekte me një ndikim në buxhetin e Bashkisë me një vlerë prej **558,800 lekë** :

- 16 subjekte për aktivitetin tregëti dhe shërbime në vlerën 190,000 lekë
- 23 subjekte për aktivitetin prodhim në vlerën 326,000 lekë
- 12 Institucione arsimore private dhe ojf në vlerën 42,800 lekë

2. Subjekte të cilat përfitojnë 50% ulje të tarifës së pastrimit, referuar të dhënave paraprake që disponojmë janë 17 subjekte me një ndikim në buxhetin e Bashkisë me një vlerë prej **376,000 lekë** :



## BASHKIA KORÇË

- 5 subjekte për aktivitetin tregëti dhe shërbime në vlerën 130,000 lekë
  - 5 subjekte për aktivitetin prodhim në vlerën 165,000 lekë
  - 2 organizata jofitimprurëse me aktivitet sportiv në vlerën 30,000 lekë
  - 5 subjekte dedikuar fëmijëve në vlerën 51,000 lekë
3. Subjekte që përjashtohen nga pagesa e tarifës së pastrimit referuar të dhënave paraprake që disponojmë janë 31 subjekte me një ndikim në buxhetin e Bashkisë me një vlerë prej **865,000 lekë** :
- Nga 14 subjekte të biznesit në vlerën 525,000 lekë
  - Nga 17 Ojf fetare në vlerën 340,000 lekë
4. Nga 3,392 familje që përjashtohen nga pagesa e tarifës së pastrimit si rezultat i lehtësive fiskale në vlerën **10,635,600 lekë**.

## 2.TARIFË NDRIÇIMI

Parashikimi për vitin 2023 është i bazuar tek zgjerimi i bazës së taksueshme nëpërmjet:

- Përditësimit dhe përmirësimit të të dhënave të sistemit të taksave dhe tarifave vendore
- Verifikimit në terren nga administrata e rajoneve dhe njësive administrative për familjet efektive
- Verifikimit në terren nga inspektorët e D.T.T.V në lidhje me subjektet që ushtrojnë aktivitet
- Bashkëpunimit dhe shkëmbimit të informacionit me Q.K.B, D.R.T, U.K.KO dhe Zyrën e Gjëndjes Civile në lidhje me nr e subjekteve dhe familjeve të regjistruara në Bashkinë Korçë

Tarifa e ndriçimit planifikohet në vlerën **51,258,028 lekë** dhe zë 4.4% të totalit të taksave dhe tarifave vendore që planifikohen për vitin 2023 dhe 10.8% të totalit të të ardhurave të parashikuara nga tarifave vendore.

Kjo tarifë planifikohet të arkëtohet nga:

- 2,621 subjekte të biznesit të vogël në vlerën **11,614,400 lekë**
- 694 subjekte të biznesit të madh në vlerën **5,924,400 lekë**
- 81 institucione shtetërore dhe ofj në vlerën **396,000 lekë**
- subjektet ndërtuese për kantieret e ndërtimit referuar numrit të lejeve të dhëna gjatë vitit 2022 në vlerën **300,000 lekë**
- 21,978 familje rezidente efektive të njësisë administrative Korçë në vlerën **15,384,600 lekë**
- 7,657 familje rezidente efektive të njësive administrative të tjera të Bashkisë Korçë në vlerën **3,804,500 lekë**
- debitorët familjarë në vlerën **9,420,868 lekë**
- debitorët e subjekteve të biznesit parashikohet në vlerën **4,413,260 lekë**



## BASHKIA KORÇË

Në planifikimin e tarifës së ndriçimit ndikim negativ kanë dhe lehtësitë fiskale apo përjashtimet në pagesën e kësaj tarife.

Për vitin 2023 vlera prej **2,500,300 lekë** do ti mungojë buxhetit të bashkisë por do jetë në buxhetet e familjeve dhe sipërmarrjeve private.

1. Subjekte të cilat përfitojnë 20 % ulje të tarifës së ndriçimit, referuar të dhënave paraprake që disponojmë janë 51 subjekte me një ndikim në buxhetin e Bashkisë me një vlerë prej **81,900 lekë** :

- 16 subjekte për aktivitetin tregëti dhe shërbime në vlerën 29,800 lekë
- 23 subjekte për aktivitetin prodhim në vlerën 39,800 lekë
- 12 Institucione arsimore private dhe ojf në vlerën 12,300 lekë

2. Subjekte të cilat përfitojnë 50 % ulje të tarifës së ndriçimit, referuar të dhënave paraprake që disponojmë janë 17 subjekte me një ndikim në buxhetin e Bashkisë me një vlerë prej **64,000 lekë** :

- 5 subjekte për aktivitetin tregëti dhe shërbime në vlerën 23,000 lekë
- 5 subjekte për aktivitetin prodhim në vlerën 20,000 lekë
- 2 Ojf sportive në vlerën 5,000 lekë
- 5 subjekte dedikuar fëmijëve në vlerën 16,000 lekë

3. Subjekte që përjashtohen nga pagesa e tarifës së ndriçimit referuar të dhënave paraprake që disponojmë janë 31 subjekte me një ndikim në buxhetin e Bashkisë me një vlerë prej **176,000 lekë** :

- 14 subjekte të biznesit në vlerën 91,000 lekë
- 17 Ojf fetare në vlerën 85,000 lekë

4. 3392 familje që përjashtohen nga pagesa e tarifës së ndriçimit si rezultat i lehtësive fiskale në vlerën **2,178,400 lekë**.

### 3.TARIFË GJELBËRIMI

Parashikimi për vitin 2023 është i bazuar tek zgjerimi i bazës së taksueshme nëpërmjet:

- Përditësimit dhe përmirësimit të të dhënave të sistemit të taksave dhe tarifave vendore
- Lehtësive fiskale të ndërmara nga Bashkia Korçë
- Verifikimit në terren nga administrata e rajoneve dhe njësive administrative për familjet efektive
- Verifikimit në terren nga inspektorët e D.T.T.V në lidhje me subjektet që ushtrojnë aktivitet.
- Bashkëpunimit dhe shkëmbimit të informacionit me Q.K.B, D.R.T, U.K.KO dhe Zyrën e Gjëndjes Civile në lidhje me nr e subjekteve dhe familjeve të regjistruara në Bashkinë Korçë.

Tarifa e gjelbërimit planifikohet në vlerën **32,143,581 lekë** dhe zë **2.8%** të totalit të taksave dhe tarifave vendore që planifikohen për vitin 2023 dhe **6.8%** të totalit të të ardhurave të parashikuara nga tarifat vendore.

Kjo tarifë planifikohet të arkëtohet nga :



## BASHKIA KORÇË

- 2,307 subjekte të biznesit të vogël në vlerën **9,129,550 lekë**
- Impakt direkt në rritjen e zhvillimit ekonomik dhe turistik, jo vetëm të qytetit të Korçës, por gjithë rajonit
- Gjallërimi i jetës sociale dhe kulturore
- Përforsim i imazhit turistik të vendit

**Kostoja Totale:** 4,153,000 Lekë

### **Titulli i projektit : “Dita e Dëborës”**

#### **Përshkrim i shkurtër i projektit:**

Dita Botërore e Dëborës u krijua me iniciativën e Federatës Botërore të Skive (FIS) dhe mbahet në datë 16 Janar për të promovuar sportet e borës në shtetet e saj anëtare, me një sërë aktiviteteve. Turizmi i dëborës duket se është shndërruar së fundmi në një nga tendencat më të pëlqyera të shqiptarëve. Tashmë dëshira për të kaluar pushime nuk mbetet vetëm në sezonin veror. Dimri është një mundësi po aq bindëse për të kaluar bukur dhe ndryshe përmes udhëtimesh apo sporteve dimërore në Korçë. Juglindja e Shqipërisë, po bëhen së fundmi destinacioni i synuar fort, pas ndërtimit të hoteleve dhe fshatrave turistikë modernë.

**Qëllimi:** Zhvillimi i turizmit në rajon përmes promovimit të sportit të skive në destinacionet turistike rreth Korçës në bashkëpunim me Federatën e Skive, si edhe rritja e interesit të vizitorëve për këtë sport.

#### **Objektiva:**

- Rritja e numrit të vizitorëve vendas dhe të huaj
- Tërheqja e vizitorëve vendas dhe të huaj përmes krijimit të zgjedhjeve alternative të argëtimit për vizitorët vendas dhe të huaj.
- Përfshirja dhe promovimi i bizneseve lokale në festë.
- Rritje të impaktit direkt dhe indirekt në rritjen e të ardhurave të bizneseve të rajonit e më gjerë.

#### **Përfituesit/ Treguesit .**

- Të gjithë banorët e Korçës dhe rajonit
- Vizitorët vendas dhe të huaj të cilët kanë mundësi argëtimi në këto vende, duke bërë që këto vende të shndërrohen për ta në destinacionet perfekte për të kaluar momente të bukura dimërore çdo vit.
- Krijimi i aktiviteteve të reja argëtuese, me synim rritjen e netëqëndrimeve të vizitorëve në Korçë
- Bizneset lokale (Hotele/bujtina/ bare/ restorante), që përfitojnë direkt në rritjen ekonomike



## BASHKIA KORÇË

**Risia dhe Qëndrueshmëria e projektit:** Projekti implementohet nga Bashkia Korçë për herë të parë, me synim promovimin e sportit të skive, e cila gjatë sezonit dimëror, tërheq vëmendjen e vizitorëve vendas dhe të huaj për të vizituar destinacionet turistike përreth Korçës.

### **Rezultate:**

- Tërheqja dhe rritje e ndjeshme e numrit të vizitorëve për të frekuentuar aktivitete në natyrë
- Promovimi i qytetit dhe aktiviteteve interesante
- Gjallërimi i jetës sociale dhe kulturore
- Përforsim i imazhit turistik të vendit, përmes aktiviteteve të reja argëtuese për banorët e Korçës si edhe vizitorët vendas dhe të huaj

**Kostoja Totale:** 500,000 Lekë

### **Titulli i projektit : “Pjesëmarrje në Panaire Kombëtare dhe Ndërkombëtare”**

### **Përshkrim i përgjithshëm i projektit:**

Për Bashkinë e Korçës turizmi është një nga prioritetet kryesore zhvillimore, jo vetëm bazuar te resurset natyrore, trashëgimninë e pasur kulturore dhe historike, por edhe tek projektet tona të shumta në këtë drejtim, investime, festa dhe aktivitete të larmishëm përgjatë gjithë vitit për të tërhequr sa më shumë vizitorë vendas dhe të huaj duke e parë këtë potencial si burim për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik. Gjatë vitit 2023 Bashkia Korçë do të marrë pjesë në aktivitete kombëtare dhe ndërkombëtare, që mund të organizohen nga institucione publike dhe private në Shqipëri ose jashtë saj dhe që kanë në fokus promovimin e vlerave turistike të vendeve pjesëmarrëse. Pjesëmarrja e Bashkisë Korçë në aktivitete të tilla, rrit numrin e vizitorëve dhe investitorëve, si edhe krijon kontakte me investitorë të huaj, agjensi turistike me të cilët Bashkia Korçë bashkëpunon në të ardhmen.

**Qëllimi:** Promovimi i vlerave turistike dhe agroturistike të Korçës, të cilat ndikojnë në zhvillimin rajonal të zonës. Rritje të bashkëpunimit me biznese që operojnë në fushën e turizmit (agjensi turistike, tour operatore, stuktura akomoduese), etj.

### **Objektivat:**

1. Zhvillimin e mëtejshëm të partneritetit publiko-privat, me synim përmirësimin e jetesës së qytetarëve si dhe nxitjen e investimeve në qytet me fokus turizmin
2. Gjallërimin e bizneseve vendase dhe të huaja.
3. Prezantimin e mundësive dhe ideve për zhvillimin e turizmit në qytetin e Korçës.

### **Përfituesit/ Treguesit:**

- mbi 20 individë sipërmarrës (50% femra, 50 % meshkuj), pjesëmarrës në panaire në nivel kombëtar
- mbi 70 biznese pjesëmarrëse në panaire në nivel kombëtar (kryesisht stuktura akomoduese hotele/ bujtina)

**Risia dhe Qëndrueshmëria e projektit:** Promovimi i qytetit të Korçës në nivel ndërkombëtar përmes hartimit të paketave turistike në bashkëpunim të përhershëm me agjensitë turistike.

### **Rezultatet:**

1. Prezantimi i qytetit të Korçës si një destinacion turistik.
2. Nxitja e investimeve në qytet dhe rritja e mundësisë për të investuar në Korçë.
3. Prezantimi i ideve të bashkisë Korçë për zhvillimin e partneritetit publiko-privat.
4. Tërheqja e investitorëve dhe turistëve vendas dhe të huaj



## BASHKIA KORÇË

**Kostoja totale:** 420,000 Lekë

### **Titulli i projektit: Festivali i Ushqimit/ Festa e Lakrorit**

#### **Përshkrim i shkurtër i projektit:**

Bashkia e Korçës, këtë vit do të organizojë me mbështetjen e bizneseve të interesuara "Festivalin e Ushqimit", i cili synon organizimin e një panairi që promovon gatimet tradicionale të Korçës. Pjesë e Festivalit të Ushqimit këtë vit do të jetë edhe Festa e Lakrorit, e cili sjell traditën e veçantë të përgatitjes së lakrorit në saç, për të gjithë vizitorët vendas dhe të huaj që e parapëlqejnë dhe e frekuentojnë këtë aktivitet të përvitshëm të kthyer në traditë. duke e bërë atë sa më atraktiv për turistët vendas dhe të huaj. Në organizimin e Festivalit të Ushqimit do të marrin pjesë dhe do të angazhohen me përgatitjen e ushqimeve tradicionale edhe nxënësit e shkollës së mesme profesionale "Isuf Gjata", të cilët morën pjesë edhe në aktivitetin e vitit të kaluar.

#### **Qëllimi:**

Promovimi i vlerave tradicionale të artit të gastronomisë dhe nxitja dhe promovimi i produkteve të rajonit, nëpërmjet aktiviteteve të cilat tërheqin numër të madh vizitorësh vendas dhe të huaj.

#### **Objektiva:**

- Rritja e numrit të vizitorëve
- Rritja e të ardhurave të bizneseve, përmes promovimit, që lidhen direkt apo indirekt me turizmin.
- Gjallërimi i jetës në qytet përmes realizimit të aktivitetit
- Trashëgimia e kulturës dhe traditës korçare në vitet e ardhshme
- Zhvillimi i turizmit në rajon, promovimi i qytetit si dhe forcimi i traditave të Korçës dhe rrethinave .
- Me qëllim gjallërimin e jetës së qytetit si dhe rizgjim dhe promovimin e vlerave të qytetit

#### **Përfituesit / Treguesit**

- Biznese lokale ( restorante/ taverna tradicionale, hotele që kanë restorant)
- 20-30 gra/ amvisa, të cilat angazhohen direkt së bashku me familjet e tyre në organizimin dhe zhvillimin e aktivitetit, duke përgatitur lakrorin në saç.
- Angazhimi i nxënësve të shkollës profesionale "Isuf Gjata", dega hoteleri – turizëm, të cilët promovohen përmes realizimit të gatimeve tradicionale të realizuara me përkushtim.
- Festa e lakrorit ndikon pozitivisht në rritjen dhe zhvillimin ekonomik të zonës duke iniciuar krijimin e sipërmarrjeve individuale të 30 grave pjesëmarrëse në festë.
- 10 bizneset e zonës
- Rreth 2000 vizitorë (qytetarë vendas dhe të huaj) të cilët shijojnë jo vetëm traditën e kulinarisë por dhe vlerat kulturore të Polenës.

Risia dhe Qëndrueshmëria e projektit:

Për më shumë se 10 vite rradhazi "Festa e Lakrorit", tashmë është kthyer në një traditë, që ka si synim rritjen e numrit të pjesëmarrësve.

#### **Rezultate:**

- Gjallërimi i jetës kulturore, artistike në Rajonin e Korçës
- Rritja e numrit të vizitorëve
- Promovim i produkteve të Rajonit



## BASHKIA KORÇË

- Promovim i vlerave kulturore

- Rritja e numrit të rinjve si frekuentues të aktiviteteve të organizuara nga bashkia

Kostoja Totale: 610,000 Lekë

### Titulli i projektit: Festa e Voskopojës

#### **Përshkrim i shkurtër i projektit:**

Voskopoja, një qendër kulturore dhe historike e rëndësishme e cila po kthehet në fshatin turistik model në Shqipëri. Festa e Voskopojës krijon një atmosferë tepër të veçantë në Voskopojë, e cila tregon më të mirën që ofron ky atraksion turistik, duke nisur nga trashëgimia kulturore, legjendat e banorëve, historia, prodhimet tradicionale, aktivitetet sportive, e për t'u mbyllur me një koncert me muzikë live. Voskopoja mbetet gjithmonë atraksioni më i preferuar dhe më tërheqës për të gjithë vizitorët vendas dhe të huaj. -

**Qëllimi:** Qëllimi i organizimit të këtij projekti është nxitja dhe promovimi i produkteve të rajonit, nëpërmjet aktiviteteve të cilat tërheqin numër të madh vizitorësh vendas dhe të huaj.

#### **Objektiva:**

- Promovimi i produkteve të rajonit

- Rritja e numrit të frekuentimit të zonave përreth Korçës.

- Gjallërimi i jetës sociale dhe kulturore

- Zhvillimi i ekonomisë lokale tek kjo zonë

#### **Përfituesit/ Treguesit**

- 35 gra/ amvisa të cilat përfshihen direkt në organizimin dhe zhvillimin e festës së Voskopojës duke përgatitur panairin e kulinarisë, produktet tipike si dhe produktet e artizanatit.

- Festa e Voskopojës ndikon pozitivisht në rritjen dhe zhvillimin ekonomik të zonës duke synuar dhe iniciuar krijimin e sipërmarrjeve individuale, pjesëmarrës në festë

- 20 bizneset e zonës

- mbi 1000 vizitorët (qytetarë vendas dhe të huaj), të cilët shijojnë jo vetëm traditën e kulinarisë por dhe vlerat e trashëgimisë kulturore të Voskopojës, sidomos gjatë fundjavë.

**Risia dhe Qëndrueshmëria e projektit:** Festa e Voskopojës është kthyer në një aktivitet të përvitshëm, që synon ta kthejë Voskopojën në destinacionin turistik më tërheqës për vizitorët vendas dhe të huaj.

#### **Rezultate:**

- Rritje të numrit të vizitorëve vendas dhe të huaj

- Promovimi i produkteve tipike lokale

- Impakt direkt në rritjen e zhvillimit ekonomik

- Gjallërimi i jetës sociale dhe kulturore

- Përforsim i imazhit turistik të vendit

Kostoja Totale: 520,000 Lekë



## BASHKIA KORÇË

### **Titulli i projektit: Festa e Mollës**

#### **Përshkrim i shkurtër i projektit:**

“Festa e mollës” tashmë një festë e kthyer në traditë, këtë vit do të organizohet në qytetin e Korçës dhe ka për qëllim promovimin e një prej produkteve më të njohura të zonës së Korçës, mollës si edhe vendosjen e bashkëpunimit të vazhdueshëm midis fermerëve me qëllim rritjen e cilësisë, konkurrueshmërisë dhe shitjen e prodhimeve, duke krijuar treg bashkëpunimi me fermerë të tjerë nga zona të ndryshme brenda dhe jashtë Shqipërisë si edhe tërheqjen e sa më shumë vizitorëve vendas dhe të huaj. Në këtë aktivitet do të jenë të pranishëm biznese që merren me grumbullimin dhe përpunimin e produkteve agro, fermerë të zonës si dhe qytetarë, të cilët do të shijojnë prodhimet e rajonit të Korçës. Bizneset dhe fermerët do të prezantojnë produktet e tyre, do të hapin dyert për të gjithë vizitorët vendas dhe të huaj për të qënë pjesë e vjeljes së mollëve tek fermat e tyre. Promovimi i bizneseve të zonës, fermerëve në panairin me baze frutin e mollës dhe produkteve të tjera të kulinarisë të gatuar dhe përgatitura nga bizneset si edhe amvisa të interesuara për të promovuar gatimet me mollë, etj. Për realizimin e aktivitetit dhe krijimin e atmosferës festive, do të realizohet një dekor i veçantë në qytet, që ka si synim të promovojë sa më mire eventin.

**Qëllimi:** Qëllimi i organizimit të këtij projekti është nxitja dhe promovimi i produkteve të rajonit, nëpërmjet aktiviteteve të cilat tërheqin numër të madh vendasish dhe të huaj.

#### **Objektiva:**

- Promovimi i produkteve të rajonit
- Rritja e numrit të frekuentimit të zonave përreth Korçës.
- Gjallërimi i jetës sociale dhe kulturore
- Zhvillimi i ekonomisë lokale tek kjo zonë

#### **Përfituesit / Treguesit**

- 20 gra/ amvisa të cilat përfshihen direkt në organizimin dhe zhvillimin e festës së mollës
- Festa e Mollës ndikon pozitivisht në rritjen dhe zhvillimin ekonomik të zonës duke iniciuar krijimin e sipërmarrjeve individuale të grave pjesëmarrëse në festë
- Bizneset e zonës
- mbi 30 fermerë të zonës të cilët promovojnë dhe tregëtojnë varietete të ndryshme të mollës
- mbi 500 vizitorët ( qytetarë vendas dhe të huaj), të cilët do të shijojnë mollën, produktet me mollë si edhe traditën e kulinarisë.
- Fëmijët pjesëmarrës së bashku me prindërit, të cilët angazhohen në vjeljen e mollëve si dhe në aktivitetet argëtuese dhe çlodhëse.

**Risia dhe Qëndrueshmëria e projektit:** Festa e Mollës organizohet për të disatin vit radhazi duke shënuar rritje të bizneseve agropërpunuese pjesëmarrëse. Aktiviteti Festa e Mollës është një aktivitet tepër interesant, i cili tashmë është kthyer në një aktivitet, që tërheq vëmendjen e shumë vizitorëve vendas dhe të huaj, të cilët vizitojnë për here të pare Korçën.



## BASHKIA KORÇË

### **Rezultate:**

- Rritje të numrit të vizitorëve vendas dhe të huaj
- Promovimi i produkteve tipike lokale
- Impakt direkt në rritjen e zhvillimit ekonomik
- Gjallërimi i jetës sociale dhe kulturore
- Përforsim i imazhit turistik të vendit

Kostoja Totale: 650,000 Lekë

### **Titulli i projektit: 2B Fest**

#### **Përshkrim i shkurtër i projektit:**

Bashkia e Korçës në kuadrin e zhvillimit ekonomik, social dhe kulturor të qytetit si dhe për të nxitur dhe promovuar talentet muzikore do të organizojë gjatë vitit 2023, aktivitetin “2B Fest” ku do të marrin pjesë grupe muzikore ose DJ profesionistë shqiptarë, të cilët do të performojnë live muzikë për një periudhë tre ditore në një prej destinacioneve më atraktive dhe turistike siç është “Pazari i Vjetër” i Korçës duke krijuar mundësi për të gjithë të apasionuarit e muzikës rock që të argëtohen nën tingujt e kësaj muzike. Festivali i rokut, krahas shumë festave dhe eventeve madhore që realizohen në Korçë, do të jetë një tjetër aktivitet madhor, i cili do të zhvillohet çdo vit duke shndërruar qytetin në proin e muzikës rock.

Qëllimi: Zhvillimi i turizmit në rajon si dhe promovimi i qytetit përmes aktiviteteve kulturore.

Objektiva:

- Rritja e numrit të vizitorëve vendas dhe të huaj
- Rritja e të ardhuravë të bizneseve që lidhen direkt apo indirekt me turizmin (bare, restorante, etj).
- Gjallërimi i jetës në qytet përmes realizimit të aktivitetit
- Zhvillimi i turizmit në rajon, promovimi i qytetit si dhe forcimi i traditave të Korçës dhe rrethinave .
- Promovimi i grupeve me artistë të rinj të talentuar

Përfituesit/ Treguesit

- 2B Festival bën bashkë:
- mbi 10 grupe të reja të muzikës rock jo vetëm nga Shqipëria por dhe nga trevat e tjera shqiptare si Kosovë dhe Maqedoni
- Të gjithë të rinjtë e rajonit të apasionuar pas muzikës rock
- Vizitorë vendas dhe të huaj

Risia dhe Qëndrueshmëria e projektit:

2B Festival synon që të kthehet në traditë dhe me një pjesëmarrje më të lartë çdo vit.

### **Rezultate:**

- Gjallërimi i jetës kulturore, artistike në Rajonin e Korçës
- Rritja e numrit të vizitorëve vendas dhe të huaj
- Promovimi i atraksioneve ku zhvillohet aktiviteti për vizitorët
- Promovim i vlerave kulturore përmes performancave muzikore live
- Rritje të numrit të të rinjve që frekuentojnë aktivitetet e organizuara nga Bashkia Korçë



## BASHKIA KORÇË

Kostoja totale: 1,500,000 Lekë

### Titulli i projektit: Korça Motor Show

#### **Përshkrim i shkurtër i projektit:**

Për të gjithë të apasionuarit e motorave, Bashkia Korçë mundëson një ditë ndryshe nga rutina e përditshme e mbushur plot me emocione dhe spektakël duke prezantuar modele të ndryshme motorash, të cilët ekspozohen në qendër të qytetit si dhe një festival “Rock” në qendër të qytetit. Aktiviteti organizohet me pjesëmarrjen e rreth 300 motoristëve nga Shqipëria, Kosova e Maqedonia, Greqia, etj, të cilët kanë realizuar aktivitete në vende të ndryshme të Shqipërisë. Organizimi i aktivitetit “Korça Motor Show” në bashkëpunim me “Riders Legend” (grupin e motoristëve korçarë) vitin e kaluar ofroi për të gjithë një super spektakël me muzikë rock, i cili u frekuentua masivisht nga banorë të Korçës, vizitorë vendas dhe të huaj, që vizituan Korçën gjatë fundjavës si edhe të apasionuar pas mjeteve motorike, të ekspozuara në shesh gjatë gjithë kohëzgjatjes së aktivitetit. Aktiviteti vazhdon për të gjithë të rinjtë me muzikë, deri në orët e vona të mbrëmjes dhe me ekspozimin e mjeteve motorike në Pazarin e Vjetër Korçë.

#### **Qëllimi:**

Zhvillimi i turizmit të aventurës në rajon si dhe promovimi i qytetit.

Objektiva:

Një risi ndryshe nga rutina e përditshme

Zhvillimi i turizmit të aventurës

Zhvillimi i ekonomisë lokale

Gjallërimi i jetës sociale dhe kulturore

Përfituesit/ Treguesit

mbi 500 pjesëmarrës në festë

mbi 10 biznese pjesëmarrëse dhe bashkë organizues në aktivitet

Kalimtarë të rastit, të cilëve ju tërheq vëmendjen aktiviteti

Vizitorët vendas dhe të huaj

Bizneset lokale ( Hotel/bujtina/ bare/ restorante), që përfitojnë direkt në rritjen e ekonomisë përmes promovimit

#### **Rezultate:**

- Pjesëmarrje më e lartë e pjesëmarrësve krahasuar me vitin e kaluar

- Promovim si një qytet i pasuruar me aktivitete dhe spektakël

- Vizitorë vendas dhe të huaj më të shumtë në numër

Kostoja Totale: 500,000 Lekë

### Titulli i Projektit: Aktivitet promovues në Kopshtet Komunitare

#### **Përshkrim i shkurtër i projektit:**

Kopshtet Komunitare nuk janë vetëm një atraksion i shtuar në Korçë, por tashmë përfaqësojnë prej 3 vitesh një model të shkëlqyer të punës vullnetare dhe bashkëpunimit komunitar, me synimin për t’u shtrirë edhe më gjerë në hapësira të tjera. Në vitin e parë të krijimit të Kopshteve Komunitare (viti 2020), janë angazhuar vullnetarisht 24 familje të cilat kanë realizuar kultivimin e frutave dhe perimeve në parcelat e Kopshteve



## BASHKIA KORÇË

Komunitare. Familjet së bashku me fëmijët e tyre kujdesen çdo ditë me shumë përkushtim gjatë gjithë kohës për punimin, plehrimin e tokës, mbjelljen, ujitjen e tokës si edhe promovimin dhe vjeljen e prodhimeve.

Gjatë sezonit të vjeshtës, janë organizuar aktivitete për promovimin e prodhimeve të marra nga parcelat e kopshteve dhe të gjitha produktet e përfituara nga kopshtet, janë dhuruar në menecat sociale, që ju shërbejnë njerëzve në nevojë. Këtë vit përmes aktiviteteve të Kopshteve Komunitare synohet të realizohen fushata ndërgjegjësuese në kopshte dhe shkolla, në kontekstin e pasurimit të oborreve me lule, por edhe krijimin e ambienteve sa më miqësore për përkujdesjen ndaj mjedisit.

**Qëllimi:** Promovimi i iniciativave vullnetare për t'u marrë me kopshtari, me qëllim përfshirjen e sa më shumë njerëzve në aktivitete të bujqësisë urbane, e cila është jo vetëm argëtuese, por edhe tepër e dobishme për të edukuar dhe nxitur tek brezat e rinj ushqyerjen e shëndetshme si edhe zhvillimin e frymës komunitare.

### **Objektiva:**

Nxitja e iniciativave të bashkëpunimit social në komunitet.

Ritja e angazhimit vullnetar të familjeve dhe edukimi i vullnetarizmit tek brezat e rinj

### **Rezultatet:**

Krijimi dhe shtimi i hapësirave të gjelbra në qytet nga 24 familjet e angazhuara vullnetarisht

Kultivimi i prodhimeve bujqësore nga më të ndryshmet, sipas dëshirës së familjeve që kujdesen për produktet në parcela

Rritja e numrit të familjeve që angazhohen vullnetarisht dhe përkujdesen për parcelat në Kopshtet Komunitare.

Tërheqja e vizitorëve vendas dhe të huaj ndaj kësaj nisme tepër të suksesshme dhe të veçantë.

Kostoja totale: 250.000 Lekë

Matrica e shpenzimeve bashkë me produktet paraqiten sipas tabelës nr. 2 bashkangjitur materailit.

Matrica e investimeve bashkë me produktet paraqiten sipas tabelës nr. 3 bashkangjitur materailit.

Në buxhetin e vitit 2023, 2024 dhe 2025 në Bashkinë Korçë do të planifikohet edhe fondi rezervë dhe fondi i kontigjencës, të cilat do të përdoren si më poshtë:

### **Fondi rezervë 04910**

Për vitin 2023 fondi i planifikuar është në vlerën 10,000 mijë lekë,

Për vitin 2024 fondi i planifikuar është në vlerën 11,773 mijë lekë,

Për vitin 2025 fondi i planifikuar është në vlerën 12,008 mijë lekë,

Fondi rezervë do të përdoret vetëm për rastet e financimit të shpenzimeve të paparashikuara, të cilat nuk njihen dhe janë të pamundura të parashikohen gjatë procesit të përgatitjes së buxhetit. Buxheti vendor përfshin një fond rezervë, të pashpërndarë, i cili miratohet nga këshilli bashkiak në buxhetin vjetor të bashkisë deri në masën 3 për qind të vlerës së përgjithshme të fondeve të miratuara, përjashtuar transfertat e kushtëzuara.

### **Fondi i kontigjencës 04940**

Për vitin 2023, 2024 dhe 2025 është planifikuar fondi i kontigjencës, i cili për vitin 2023 është në vlerën 10,000 mijë lekë, për vitin 2024 në vlerën 9,811 mijë lekë dhe për vitin 2025 10,006 mijë lekë.



## BASHKIA KORÇË

Buxheti vendor përfshin një fond kontigjence, të pashpërndarë, i cili miratohet nga këshilli bashkiak në buxhetin vjetor të bashkisë deri në masën 3 për qind të vlerës së përgjithshme të fondeve të miratuara, përjashtuar transfertat e kushtëzuara. Fondi i kontigjencës është fondi i pashpërndarë, që krijohet për të mbuluar risqet e mundshme, për të ardhurat dhe shpenzimet, gjatë zbatimit të buxhetit. Gjithashtu fondi i kontigjencës krijohet për të përballuar edhe efektet e mosrealizimit të të ardhurave dhe efektet e paparashikuara të normave të interesit.

### 8.4.Mbrojtja e Mjedisit AD122

#### 8.4.1 Vështirim i përgjithshëm

Mbledhja, depozitimi i mbeturinave, trajtimi, pastrimi i rrugëve, shesheve, rrugicave, tregjeve, kopshteve publike, parqeve etj. Mbrojtja e ajrit dhe e klimës, mbrojtja e tokave dhe ujrave nëntokësore, reduktimi i zhurmave dhe vibracioneve si dhe mbrojtja ndaj rrezatimeve. Veprimtaritë dhe politikat për mbrojtjen mjedisore

#### 8.4.2. Përshkrimi i aktiviteteve të programit

Administrim, mbikëqyrje, inspektim organizim ose mbështetje e sistemeve të grumbullimit, trajtimit dhe eliminimit të mbetjeve;

Mbledhja, largimi dhe trajtimi i mbetjeve të ngurta dhe shtëpiake;

Grante, hua ose financime për të mbështetur ndërtimin, mirëmbajtjen ose përmirësimin e këtyre sistemeve;

Pastrimi i rrugëve, parqeve etj.

Masa mbrojtëse për cilësinë e ajrit, tokës dhe ujit nga ndotja;

Ndërtim, mirëmbajtje dhe vënie në funksionim e sistemeve të monitorimit të ndotjes, si dhe masave për mbrojtjen nga ndotja akustike. Administrim, mbikëqyrje, inspektim, organizim ose mbështetje e veprimtarive që lidhen me kontrollin dhe zvogëlimin e ndotjes;

Grante, hua ose financime për të mbështetur veprimtaritë që lidhen me uljen dhe kontrollin e ndotjes;

Zhvillimi i aktiviteteve edukuese dhe promovuese, të cilat lidhen me mbrojtjen e mjedisit.

Administrimi, kordinimi dhe monitorimi i politikave, planeve, programeve dhe buxheteve për promovimin e mbrojtjes mjedisore;

Prodhim dhe përhapje e informacionit të përgjithshëm për mbrojtjen dhe ndërgjegjësimin mjedisor.

Identifikim, kontroll dhe menaxhim i burimeve ujore brenda territorit të njësisë së vetëqeverisjes vendore

Buxheti i planifikuar për programin mbështetja për zhvillimin ekonomik është 177,224 mijë lekë si më poshtë:

shpenzime personeli	4,289 mijë lekë
shpenzime korrente	157,935 mijë lekë
Shpenzime për investime	15,000 mijë lekë

**Fondi i planifikuar për paga** për vitin 2023 për këtë program do të jetë në vlerën 3,682 mijë lekë.

**Fondi i planifikuar për zërin sigurime shoqërore dhe shëndetësore** do të jetë në vlerën 607 mijë lekë.

V510KO1 Pagesa për supervisorin dhe specialistët e mjedisit

**Fondi i planifikuar për shpenzime operative** për këtë program është në vlerën 120,015 mijë lekë

**Fondi i planifikuar për transfertat tek organizatat** për këtë program është në vlerën 37,921 mijë lekë

**Fondi i planifikuar për shpenzime për investime** për këtë program është në vlerën 15,000 mijë



## BASHKIA KORÇË

000/lekë

## PBA 2023-2025

## Shpenzimet Totale të Bashkisë sipas Kategorive Ekonomike

Programi AD122 Mbrojtja e Mjedisit

## Shpenzimet e Bashkisë (000 ALL)

Emri i Artikullit	Kodi i Artikullit	2020	2021	2022	2022	2023	2024	2025
		Fakti	Fakti	Buxheti Fillestar	Buxheti Pritshëm	Plani	Plani	Plani
<b>Paga &amp; Sigurime</b>								
Paga, Shpërblime & Tjera Personeli	600	2,425.0	1,917.0	2,100.0	2,142.0	3,682.0	560.0	570.0
Sigurimet Shoq. & Shëndetësore	601	405.0	320.0	351.0	358.0	607.0	93.0	95.0
<b>Shpenzime Korente të Tjera</b>								
Mallra dhe Shërbime	602	74,884.0	82,027.0	83,582.0	79,979.0	120,014.6	122,284.0	122,284.0
Subvencion	603	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Transferta të Brendshme	604	27,107.0	49,996.0	36,260.0	40,606.0	37,920.8	40,300.0	40,501.0
Transferta të Jashtme	605	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Transferta për Buxh. Famil. & Indiv.	606	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Të Tjera Huamarrje Brendshme (dala)	166	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Interesa për Huamarrje Brendshme	651	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Rezervat	609	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
<b>Shpenzime Kapitale</b>								
Aktive të Patrupëzuara	230	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Aktive të Trupëzuara	231	0.0	0.0	0.0	0.0	15,000.0	0.0	0.0
Shpenzime Transferime Kapitale	232	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Të Dala Huadhënie & Nënhuadh. Brendsh.	255	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
<b>TOTALI</b>		<b>104,821.0</b>	<b>134,260.0</b>	<b>122,293.0</b>	<b>123,085.0</b>	<b>177,224.4</b>	<b>163,237.0</b>	<b>163,450.0</b>

Matrica e shpenzimeve operative dhe produkteve paraqitet si më poshtë:

Institucioni	Përshkrimi i shpenzimeve operative	PI 2023	V510K02	V510K03	TOTAL
			Pastrimi i qytetit	Transportimi, depozitimi dhe trajtimi i mbetjeve	
<b>AD122- Mbrojtja e Mjedisit</b>			<b>120,014,600</b>	<b>37,920,745</b>	<b>157,935,345</b>
Bashkia	Sherbimi i pastrimit	120,014,600	120,014,600		
Bashkia	Kontribut i Bashkise per KRWM	37,920,745		37,920,745	

Vlera e planifikuar për shërbimin e pastrimit për vitin 2023 do të jetë në vlerën 120,015 mijë lekë. Kjo vlerë përbëhet nga: (vlera e kontratës ekzistuese deri në qershor 2023 dhe nga korrik-dhjetor 2023 është planifikuar sipas vlerës së llogaritur nga zbatimi i VKM nr. 319 datë 31.5.2018 “Për miratimin e masave për kostot e Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve”. Vlera e planifikuar për tu prokuruar për shërbimin e pastrimit për 1 vit do të jetë në vlerën 160,411,192 lekë

Shërbimi i pastrimit është një nga shërbimet më të rëndësishme që kryen Bashkia në komunitet. Ky shërbim kryhet nëpërmjet kontraktimit me palë të treta brenda qytetit dhe për grumbullimin dhe transportin e



## BASHKIA KORÇË

mbeturinave të fshatrave. Objekti i këtij shërbimi është pastrimi i rrugëve dhe trotuareve, evadimi i mbetjeve urbane në qytetin e Korçës dhe transportimi i tyre për në landfillin rajonal, lagia e rrugëve, evadimi i dëborës në stinën e dimrit dhe hedhja e kripës për lehtësimin e qarkullimit të automjeteve dhe njerëzve si dhe grumbullimi dhe evadimi i mbetjeve të fshatrave.

Matrica e investimeve me produktet paraqitet si më poshtë:

									AD122					
									V532K01					
Nr.	Kod grupi	Kod_Tiulli	Kod_Artikulli	Programi	Institucioni	Përshkrimi i shpenzimeve operative	PI 2023	Termilozimi i banesave ne bashkepronesi						TOTAL
AD122-Mbrojtja e Mjedisit									15,000,000	.	.	.	.	15,000,000

### 8.5. Programi: Shërbime Publike Vendore AE122

#### 8.5.1. Vështrim i përgjithshëm

Ky program siguron ofrimin e shërbimeve publike vendore

#### 8.5.2. Përshkrimi i aktiviteteve të programit

Ky program përfshin funksionin e menaxhimit të rrjetit rrugor rural, menaxhimin e ujitjes dhe kullimit, transportin publik, ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e varrezave publike dhe të dëshmorëve, si dhe garantimin e shërbimit publik të varrimit, mirëmbajtja e sistemeve rrugore dhe strukturave të transportit (rrugë, ura, tunele, parkime, terminale autobusësh, rrugë këmbësore dhe korsi biçikletash etj.) dhe sinjalizimi rrugor i trotuareve dhe shesheve publike vendore nën administrimin dhe përgjegjësitë e njësisë të vetëqeverisjes vendore.

Buxheti i këtij program është në vlerën 75,666 mijë lekë i detajuar si më poshtë:

shpenzime personeli	1,166 mijë lekë
shpenzime korrente	14,500 mijë lekë
shpenzime për investime	60,000 mijë lekë

**Fondi i planifikuar për paga** për vitin 2023 për këtë program do të jetë në vlerën 1,000 mijë lekë.

**Fondi i planifikuar për zërin sigurime shoqërore dhe shëndetësore** do të jetë në vlerën 166 mijë lekë.

V626KOA Pagesa për supervizorin e shërbimit të mirëmbajtjes së varrezave publike dhe të dëshmorëve

V457K01 Pagesa për supervizorin e shërbimit të transportit urban

**Fondi i planifikuar për shpenzime operative** për këtë program është në vlerën 4,500 mijë lekë

**Fondi i planifikuar për subvencionin për transportin urban** për këtë program është në vlerën 10,000 mijë lekë

**Fondi i planifikuar për shpenzime për investime** për këtë program është në vlerën 60,000 mijë

Në tabelën e mëposhtme jepen shpenzimet totale sipas kategorive ekonomike të këtij programi, i cili do të menaxhohet nga Bashkia dhe Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, dhe konkretisht nga totali prej 614,011 mijë lekë, 75,666 mijë lekë do të menaxhohen nga Bashkia dhe pjesa tjetër nga Ndërmarrja e Shërbimeve Publike.



BASHKIA KORÇË

000/lekë

PBA 2023-2025								
Shpenzimet Totale të Bashkisë sipas Kategorive Ekonomike								
Programi	AE122	Shërbimet Publike Vendore						
Shpenzimet e Bashkisë (000 ALL)								
Emri i Artikullit	Kodi i Artikullit	2020	2021	2022	2022	2023	2024	2025
		Fakti	Fakti	Buxheti Fillestar	Buxheti Pritshëm	Plani	Plani	Plani
<b>Paga &amp; Sigurime</b>								
Paga, Shpërbime & Tjera Personeli	600	143,749.0	165,327.0	191,752.0	171,268.0	216,666.0	200,083.0	202,896.0
Sigurimet Shoq. & Shëndetësore	601	24,006.0	27,610.0	32,075.0	28,608.0	36,016.0	33,838.0	34,226.0
<b>Shpenzime Korente të Tjera</b>								
Mallra dhe Shërbime	602	187,869.0	220,670.0	250,829.0	252,869.0	267,674.0	250,603.0	251,826.0
Subvencion	603	5,349.0	9,999.0	10,000.0	10,000.0	10,000.0	10,000.0	10,000.0
Transferta të Brendshme	604	0.0	313.0	2,525.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Transferta të Jashtme	605	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Transferta për Buxh. Famil. & Indiv.	606	503.0	508.0	300.0	845.0	0.0	0.0	0.0
Të Tjera Huamarrje Brendshme (dala)	166	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Interesa për Huamarrje Brendshme	651	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Rezervat	609	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
<b>Shpenzime Kapitale</b>								
Aktive të Patrupëzuara	230	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Aktive të Trupëzuara	231	71,901.0	19,431.0	93,545.0	72,532.0	83,655.0	126,998.0	145,313.0
Shpenzime Transferime Kapitale	232	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Të Dala Huadhënie & Nënhuadh. Brendsh.	255	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
<b>TOTALI</b>		<b>433,377.0</b>	<b>443,858.0</b>	<b>581,026.0</b>	<b>536,122.0</b>	<b>614,011.0</b>	<b>621,522.0</b>	<b>644,261.0</b>

Matrica e shpenzimeve operative me produktet

Institucioni	Përshkrimi i shpenzimeve operative	PI 2023	V626KOA
			Mirembajtja e varrezave
<b>AE122- Shërbimet Publike Vendore</b>			<b>4,500,000</b>
Bashkia	Mirembajtja e Varrezave Publike dhe Vendore	4,500,000	4,500,000

Subvencionin për shërbimin urban dhe me produkt **V457KO3** kryhet nga shoqëria “Ortakëria Korca” sh.p.k, e cila subvencionohet duke u bazuar në kontratën e lidhur me këtë shoqëri, e cila përfundon më qershor 2023. Në buxhetin e vitit 2023, ky shërbim planifikohet në vlerën **10,000 mijë lekë**.

Matrica e investimeve me produktet si më poshtë:



## BASHKIA KORÇË

								AE122					
								V452K05	V626K01	V424K07	V644K00		TOTAL
Nr.	Kod_ grupi	Kod_ Tull	Kod_ Artikulli	Programi	Institucioni	Përshkrimi i shpenzimeve operative	PI 2023	Investime ne rruge	Shërbimi Publik Komunal, Gjelberimit, varrezat	Shërbimi I mirëmbajtjes së Kanaleve Ujttjes dhe Kullimit	Shërbimi I mirëmbajtjes së Ndricimit Publik		
<b>AE122-Sherbimet Publike Vendore</b>								60,000,000	-	-	-	-	60,000,000
16	00	04520	05	2310000	Rrjeti rrgor rural	Bashkia	Investime ne infrastrukturen rrgore	60,000,000	60,000,000				

### 8.6. Programi: Arsimi Bazë dhe Parashkollor AG122

#### 8.6.1. Vështrim i përgjithshëm

Mbështetja e arsimit bazë dhe parashkollor. Administrim dhe rregullim i sistemit arsimor parashkollor në kopshte dhe çerdhe.

#### 8.6.2. Përshkrimi i aktiviteteve të programit

Shpenzime për paga për mësuesit e kopshteve të fëmijëve dhe stafit mbështetës;

Programë mësimore për trajnimin e edukatorëve dhe mësuesve;

Furnizimi dhe mbështetja me ushqim e kopshteve;

Ndërtim dhe mirëmbajtje e strukturave shkollore.

Buxheti i këtij programi është në vlerën 66,946 mijë lekë, e planifikuar për shpenzime operative (shpenzime karburanti dhe shpenzime energji, ujë dhe telefon për Shoqërinë e Doktrinës së Krishterë ose shkolla e Maltës) dhe investime dhe konkretisht:

Shpenzime korrente 900 mijë lekë

Shpenzime për investime 66,046 mijë lekë

Totali i buxhetit për programin arsimit bazë dhe parashkollor do të jetë 460,359 mijë lekë, ku përfshihen shpenzime të cilat menaxhohen nga Bashkia në vlerën 66,946 mijë lekë dhe pjesa tjetër do të menaxhohet nga Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse e Arsimit dhe Cerdhes.

000/lekë



## BASHKIA KORÇË

PBA 2023-2025

### Shpenzimet Totale të Bashkisë sipas Kategorive Ekonomike

Programi **AG122** **Arsimi Bazë përfshirë Arsimin Parashkollor**

#### Shpenzimet e Bashkisë (000 ALL)

Emri i Artikullit	Kodi i Artikullit	2020	2021	2022	2022	2023	2024	2025
		Fakti	Fakti	Buxheti Fillestar	Buxheti Pritshëm	Plani	Plani	Plani
<b>Paga &amp; Sigurime</b>								
Paga, Shpërblime & Tjera Personeli	600	175,776.0	188,855.0	197,491.0	206,821.0	210,200.0	209,335.0	211,946.0
Sigurimet Shoq. & Shëndetësore	601	29,559.0	31,940.0	33,550.0	34,492.0	34,331.0	34,633.0	34,722.0
<b>Shpenzime Korente të Tjera</b>								
Mallra dhe Shërbime	602	56,847.0	95,380.0	86,470.0	84,669.0	108,649.3	108,449.0	110,011.0
Subvencion	603	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Transferta të Brendshme	604	0.0	0.0	1,000.0	2,119.0	22,137.6	2,000.0	2,000.0
Transferta të Jashtme	605	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Transferta për Buxh. Famil. & Indiv.	606	15,528.0	23,742.0	0.0	356.0	0.0	0.0	0.0
Të Tjera Huamarrje Brendshme (dala)	604	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Interesa për Huamarrje Brendshme	605	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Rezervat	606	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
<b>Shpenzime Kapitale</b>								
Aktive të Patrupëzuara	230	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Aktive të Trupëzuara	231	22,861.0	22,735.0	21,696.0	19,601.0	85,041.0	22,100.0	22,100.0
Shpenzime Transferime Kapitale	230	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Të Dala Huadhënie & Nënhuadh. Brendsh.	231	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
<b>TOTALI</b>		<b>300,571.0</b>	<b>362,652.0</b>	<b>340,207.0</b>	<b>348,058.0</b>	<b>460,358.9</b>	<b>376,517.0</b>	<b>380,779.0</b>

### Matrica e shpenzimeve operative me produktet

Institucioni	Përshkrimi i shpenzimeve operative	PI 2023	V912KO1	V912KO2	V912KO3	V912KO4	V912KO5	V912KOA	V912KOB							TOTAL
			Objekte të Arsimit Bazë të mirëmbajtura	Rikonstrukcion Shkollash Arsimit Bazë	Objekte Arsimit Bazë në funksionim	Fëmijë në Kamp Veror	Kite shkollore	Projektet e inovacionit	Shkolla e Maltes							
<b>AG122- Arsimi Baze dhe Arsimit Parashkollor</b>			-	-	-	-	-	-	900,000	-	-	-	-	-	-	900,000
Bashkia	Shpenz. karburanti për shkollën e Maltes (blerje gaz)	500,000							500,000							
Bashkia	Shp. energji, uje, telefon për shkollën e Maltes	400,000							400,000							

### Matrica e investimeve dhe produktet si më poshtë:



## BASHKIA KORÇË

								AG122					
								V912KO1	V912KOC	V912KOD	V912KOA		
Nr.	Kod_grupi	Kod_Tiulli	Kod_Artikulli	Programi	Institucioni	Përshkrimi i shpenzimeve operative	PI 2023	Objekte të Arsimit Bazë të mirëmbajtura	Rikonstruksion Shkollash Arsimit Bazë	Rikonstruksion biblioteka e femijeve	Projektet e inovacionit	TOTAL	
<b>AG122- Arsimi Baze perfshire Arsimin Parashkollor</b>								-	35,522,618	30,523,506	-	-	66,046,124
1	00	09120	05	2310000	Arsimi baze dhe parashkollor	Bashkia	Rikonstruksioni i shkolles Naum Veqilharxhi me termoizolim dhe palester (bashkefinancim)	15,000,000.00		15,000,000			
2	00	09120	05	2310000	Arsimi baze dhe parashkollor	Bashkia	Mbikqyrje per objektin Rikonstruksioni i shkolles Naum Veqilharxhi me termoizolim dhe palester	670,211.00		670,211			
3	00	09120	05	2310000	Arsimi baze dhe parashkollor	Bashkia	Kolaudim I punimeve Rikonstruksioni i shkolles Naum Veqilharxhi me termoizolim dhe palester	67,196.00		67,196			
4	00	09120	05	2310000	Arsimi baze dhe parashkollor	Bashkia	Rikonstruksion I shkolles 9 vj Vithkuq (Bashkefinancim)	9,000,000.00		9,000,000			
5	00	09120	05	2310000	Arsimi baze dhe parashkollor	Bashkia	Mbikqyrje per objektin Rikonstruksion I shkolles 9 vj Vithkuq	479,916.00		479,916			
6	00	09120	05	2310000	Arsimi baze dhe parashkollor	Bashkia	Kolaudim per punimet ne objektin Rikonstruksion I shkolles 9 vj Vithkuq	43,590.00		43,590			
7	00	09120	05	2310000	Arsimi baze dhe parashkollor	Bashkia	Ndertim I palestres se shkolles Sevasti Qirjazi	10,080,000.00		10,080,000			
8	00	09120	05	2310000	Arsimi baze dhe parashkollor	Bashkia	Mbikqyrje per objektin Ndertim I palestres se shkolles Sevasti Qirjazi	166,563.00		166,563			
9	00	09120	05	2310000	Arsimi baze dhe parashkollor	Bashkia	Kolaudim I punimeve per objektin Ndertim I palestres se shkolles Sevasti Qirjazi	15,142.00		15,142			
10	00	09120	05	2310000	Arsimi baze dhe parashkollor	Bashkia	Rikonstruksion I bibliotekes se femijeve Thoma Turtulli	30,000,000.00		30,000,000			
11	00	09120	05	2310000	Arsimi baze dhe parashkollor	Bashkia	Mbikqyrje per objektin Rikonstruksion I bibliotekes se femijeve Thoma Turtulli	479,916.00		479,916			
12	00	09120	05	2310000	Arsimi baze dhe parashkollor	Bashkia	Kolaudim I punimeve per objektin Rikonstruksion I bibliotekes se femijeve Thoma Turtulli	43,590.00		43,590			

### 8.7. Programi: Arsimi i Mesëm i Përgjithshëm AH122

#### 8.7.1. Vështrim i përgjithshëm

Ky program mbështet arsimin e mesëm, duke siguruar dhe mirëmbajtur ambientet shkollore dhe pagesën e stafit mbështetës. Programe arsimore dhe trajnim për mësuesit.ka në fokus zhvillimin e projekteve për të rinjtë.

#### 8.7.2. Përshkrimi i aktiviteteve të programit

Ndërtim dhe mirëmbajtje e institucioneve shkollore;

Ndërtim, rehabilitim dhe mirëmbajtje e ndërtesave arsimore e sistemit shkollor parauniversitar, me përjashtim të shkollave profesionale;

Shpenzimet për paga për stafin mbështetës.

Administrim,inspektim, organizim ose mbështetje për transport, ushqim, strehim, kujdes mjekësor dhe dentar për fëmijët e shkollave;

Mbështetje për trajnimin e mëtejshëm të mësuesve

Ndërtim dhe mirëmbajtje konviktesh.



## BASHKIA KORÇË

Buxheti i këtij program është në vlerën 30,349 mijë lekë e detajuar si më poshtë:

- shpenzime korrente në vlerën 410 mijë lekë
- shpenzime për investime në vlerën 29,939 mijë lekë

Totali i buxhetit për programin arsimit mesëm i përgjithshëm do të jetë 107,901 mijë lekë, ku përfshihen shpenzime të cilat menaxhohen nga Bashkia në vlerën 30,349 mijë lekë dhe pjesa tjetër do të menaxhohet nga Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse e Arsimit dhe Cerdhes.

000/lekë

PBA 2023-2025								
Shpenzimet Totale të Bashkisë sipas Kategorive Ekonomike								
Programi	AH122	Arsimi i Mesëm i Përgjithshëm						
Shpenzimet e Bashkisë (000 ALL)								
Emri i Artikullit	Kodi i Artikullit	2020	2021	2022	2022	2023	2024	2025
		Fakti	Fakti	Buxheti Fillestar	Buxheti Pritshëm	Plani	Plani	Plani
<b>Paga &amp; Sigurime</b>								
Paga, Shpërblyme & Tjera Personeli	600	27,599.0	27,953.0	29,992.0	31,366.0	30,200.0	31,477.0	31,477.0
Sigurimet Shoq. & Shëndetësore	601	4,609.0	4,668.0	5,000.0	5,260.0	5,623.0	5,000.0	5,000.0
<b>Shpenzime Korente të Tjera</b>								
Mallra dhe Shërbime	602	24,184.0	27,721.0	35,404.0	36,695.0	36,139.0	32,792.0	32,792.0
Subvencion	603	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Transferta të Brendshme	604	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Transferta të Jashtme	605	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Transferta për Buxh. Famil. & Indiv.	606	1,624.0	1,642.0	10,521.0	1,981.0	4,500.0	2,000.0	2,000.0
Të Tjera Huamarrje Brendshme (dala)	166	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Interesa për Huamarrje Brendshme	651	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Rezervat	609	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
<b>Shpenzime Kapitale</b>								
Aktive të Patrupëzuara	230	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Aktive të Trupëzuara	231	2,789.0	4,492.0	37,900.0	26,475.0	31,438.8	26,415.0	26,415.0
Shpenzime Transferime Kapitale	232	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Të Dala Huadhënie & Nënhuadh. Brendsh.	255	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
<b>TOTALI</b>		<b>60,805.0</b>	<b>66,476.0</b>	<b>118,817.0</b>	<b>101,777.0</b>	<b>107,900.8</b>	<b>97,684.0</b>	<b>97,684.0</b>

Matrica e shpenzimeve operative me produktet



## BASHKIA KORÇË

								V923KO2	V923KO3	V923KPO9	V923KOA
Nr.	Kod_grupi	Kod_Titulli	Kod_Artikulli	Programi	Institucioni	Përshkrimi i shpenzimeve operative	PI 2023	Objekte te arsimit parauniversitar te mirembajtura	Objekte te arsimit parauniversitar ne funksionim normal	Sherbim I stafit te konvikteve	Pagesat per aktivitetet per te rinjte
<b>AH122- Arsimi I Mesem I Pergjithshem</b>								-	-	-	410,000
1	00	09230	6020000	Arsim I mesem I pergjithshem	Bashkia	Sherbime te printimit & publikimit	100,000				100,000
2	00	09230	6020000	Arsim I mesem I pergjithshem	Bashkia	Shpenzime dekor	100,000				100,000
3	00	09230	6020000	Arsim I mesem I pergjithshem	Bashkia	Shpenzime qeramarje aparate dhe pajisje	30,000				30,000
4	00	09230	6020000	Arsim I mesem I pergjithshem	Bashkia	Shpenzime per te tjera materiale dhe sherbime	130,000				130,000
5	00	09230	6020000	Arsim I mesem I pergjithshem	Bashkia	Shpenzime honorare	50,000				50,000

Këto shpenzime janë planifikuar për realizimin e aktiviteteve për të rinjtë si më poshtë:

### **Titulli i Projektit: 9 Maj, Dita e Europës**

#### **Përshkrim i shkurtër i projektit:**

Në kuadër të ditës së Evropës, e cila celebrimet në çdo datë 9 Maj, me nxënës të shkollave publike do të organizohet një aktivitet sensibilizues me material artistike të përzgjedhura nga vetë nxënësit për të treguar mënyrën e krijimit, arsyet, zhvillimin dhe ecurinë e Bashkimit Evropian. Ky aktivitet do të zhvillohet me pjesëmarrjen e një numri të konsiderueshëm pjesëmarrësish dhe do të vazhdojë rreth një orë. Pjesëmarrësit do të kenë mundësi të njihen më mënyrën e krijimit, arsyet, zhvillimin dhe ecurinë e Bashkimit Evropian nëpërmjet krijimeve dhe materialeve të sjella nga vetë nxënësit. Në këtë kuadër, për realizimin e aktivitetit do të realizohet një dekor në qytet, për të krijuar atmosfere festive.

**Qëllimi:** Organizimi i një aktiviteti sensibilizues për të ndërgjegjësuar brezin e ri me aktivitet me fokus Bashkimin Evropian.

#### **Objektiva:**

- Evidentimi i talenteve të të rinjve në fusha të ndryshme artistike
- Pjesëmarrje aktive në aktivitete që lidhen me Bashkimin Evropian
- Ndërgjegjësim i tyre si qytetarë të ardhshëm të Bashkimit Evropian

**Risia dhe Qëndrueshmëria e projektit:** Ky aktivitet përkon me një ditë ndërkombëtare e cila festohet në të gjitha vendet Evropiane dhe si e tillë ky projekt do të ketë një qëndrueshmëri të gjatë. Nga viti në vit duke u bazuar tek eksperiencat do të përmirësohet duke iu përshtatur dhe tematikave të caktuara. Bashkia e Korçës e ka të planifikuar këtë aktivitet duke marrë shkas dhe nga ngritja dhe funksionimi i Njesisë së Intergimit pranë kësaj bashkie.

#### **Rezultate:**

- Krijimi i aktivitetit me sukses
- Përfshirja e nxënësve të shkollave të Bashkisë Korçë në organizimin e këtij aktiviteti.
- Përcjella e mesazhit tek një numër i konsiderueshëm nxënësish dhe shkëmbim praktike me shkolla të tjera të qytetit
- Angazhimi i nxënësve në gjetjen e materialeve dhe zgjerimi i njohurive të tyre në këtë drejtim.



## BASHKIA KORÇË

**Kostoja Totale:** 230,000 Lekë

### **Titulli i Projektit: Panairi i Rinisë**

**Përshkrim i shkurtër i projektit:** Bashkia Korçë do të organizojë gjatë vitit 2023, aktivitetin “Panairi i Rinisë”, i cili ka për qëllim promovimin e talenteve të të rinjve në fusha të ndryshme si art, pikturë, muzikë, letërsi, koreografi etj. Qëllimi është sensibilizimi i të rinjve të tjerë të qytetit të Korçës dhe më gjerë se kur ekziston talenti dhe dëshira, realizohen iniciativa të suksesshme jo vetëm individuale, por me impakt për gjithë komunitetin. Aktiviteti do të organizohet me mbështetjen e nxënësve të shkollave të Bashkisë Korçë si edhe organizata rinore të interesuara për të marrë pjesë nëpanair.

**Qëllimi:** Promovimi i talenteve të reja të të rinjve në fusha të ndryshme (letërsi, kulturë, shkencë, art, etj).

#### **Objektiva:**

- Aktivizimi i të rinjve dhe rritja e interesit për të shpalosur aftësitë e tyre
- Krijimi i mundësive për t’u promovuar përmes aftësive dhe talenteve të tyre në tregun e punës.
- Krijimi i mundësive dhe iniciativave të të rinjve për t’u vetëpunësuar.

#### **Përfituesit/ Treguesit:**

- Të rinjtë e qytetit të Korçës, të cilët kanë mundësinë të shpalosin aftësitë e tyre në fusha të ndryshme.
- Promovimi i talenteve të reja për t’u integruar me kërkesat e tregut
- Promovimi i organizatave rinore, të cilat kanë mundësi të bashkëpunojnë me Bashkinë për realizimin e aktiviteteve të përbashkëta në dobi të rinisë.

**Risia dhe Qëndrueshmëria e projektit:** Projekti do të realizohet për herë të parë, me mbështetjen e të rinjve nga shkollat e qytetit të Korçës, duke krijuar kështu mundësinë e promovimit dhe pjesëmarrjes së organizatave rinore, të cilat së bashku me Bashkinë kanë mundësi të realizojnë aktivitete dhe projekte të përbashkëta.

#### **Rezultate:**

- Krijimi i mundësive për promovimin e aftësive dhe talenteve të të rinjve, me synim përfshirjen dhe aktivizimin e të rinjve.

**Kostoja Totale:** 180.000 Lekë

Matrica e investimeve me produktet si më poshtë:



## BASHKIA KORÇË

								AH122					
								V923KO1	V923KO2	V923KO6	V923KO0		TOTAL
Nr.	Kod grupi	Kod Tull	Kod Artikulli	Programi	Institucioni	Përshkrimi i shpenzimeve operative	PI 2023	Investime ne shkola	Objekte të Arsimit Parauniversitar të mirëmbajtura	Rikonstruksion I shkollave arsimi I mesem	Rikonstruksion I shkollave arsimi I mesem		
<b>AH122- Arsimi I Mesem I Pergjithshem</b>								<b>4,045,538</b>	<b>-</b>	<b>14,856,588</b>	<b>11,036,972</b>	<b>-</b>	<b>29,939,098</b>
1	00	09230	05	2310000	Arsimi I mesem I pergjithshem	Bashkia	Rikonstruksion dhe shtese shkola e mesme "Themistokli Germenji"	4,045,538.00	4,045,538				
2	00	09230	05	2310000	Arsimi I mesem I pergjithshem	Bashkia	Terrenet sportive shkola Themistokli Germenji	14,585,720.00		14,585,720			
3	00	09230	05	2310000	Arsimi I mesem I pergjithshem	Bashkia	Mbikqyrje per objektin Terrenet sportive shkola Themistokli Germenji	248,296.00		248,296			
4	00	09230	05	2310000	Arsimi I mesem I pergjithshem	Bashkia	Kolaudim I punimeve per objektin Terrenet sportive shkola Themistokli Germenji	22,572.00		22,572			
5	00	09230	05	2310000	Arsimi I mesem I pergjithshem	Bashkia	Rikonstruksion I shkolles "Ymer Dishnica" bashkefinansim	10,500,000.00			10,500,000		
6	00	09230	05	2310000	Arsimi I mesem I pergjithshem	Bashkia	Mbikqyrje e objektit Rikonstruksion I shkolles "Ymer Dishnica"	488,624.00			488,624		
7	00	09230	05	2310000	Arsimi I mesem I pergjithshem	Bashkia	Kolaudim I punimeve per objektin Rikonstruksion I shkolles "Ymer Dishnica"	48,348.00			48,348		

### 8.8. Programi: Përkujdesi social AI 122

#### 8.8.1. Vështrim i përgjithshëm

Krijimi dhe administrimi i shërbimeve sociale, në nivel vendor, për shtresat në nevojë, personat me aftësi të kufizuara, fëmijët, gratë, gratë kryefamiljare, gratë e dhunuara, viktimat e trafikut, nëna apo prindër me shumë fëmijë, të moshuarit etj., sipas mënyrës së përcaktuar me ligj. Dhënia e ndihmës në para dhe në natyrë për personat e moshuar, për të lehtësuar jetën e tyre të përditshme, integrimin në jetën shoqërore dhe për të siguruar akomodimin e tyre. Ofrimi i asistencës në para dhe në natyrë, për të dhënë mbrojtje shoqërore për familjet, fëmijët. Ndërtim dhe administrim i qendrave për ofrimin e shërbimeve sociale vendore. Mbulimi i kostove për ofrimin e shërbimit të çerdhes pranë njësive vendore për fëmijët e moshës nga 0 deri në 3 vjeç. Ofrimi i përfitimeve në para dhe në natyrë për të siguruar mbrojtje shoqërore për personat e papunësuar; marrja e masave për të riintegruar personat e papunë në tregun e punës dhe për të zvogëluar rrezikun e papunësisë të grupeve të veçanta. Strehim i përshtatshëm për njerëzit në nevojë, ndërtimi dhe administrimi i banesave për strehimin social.

#### 8.8.2. Përshkrimi i aktiviteteve të programit

- Përfitime në para dhe në natyrë për familjet që kanë fëmijë në kujdestari;
- Përfitime në para, si pagesa për nëna me fëmijë, grante për lindje, përfitime për kujdes për prindërit, pagesa për fëmijët ose familjare, pagesa të tjera periodike apo të menjëhershme për të mbështetur familjet ose për t'i ndihmuar ato të përballojnë kostot e nevojave specifike (për shembull, familjet me një prind të vetëm ose familjet me fëmijë të paaftë). Mbështetje të pjesshme për faturën e energjisë elektrike dhe konsumin e ujit dhe shërbimet sanitare;
- Ndihmë financiare, asistencë për pagesën e një kujdestareje që kujdeset për fëmijët gjatë ditës;



## BASHKIA KORÇË

- Strehë dhe ushqim dhënë fëmijëve dhe familjeve në mënyrë të përhershme (jetimore, familje kujdestare etj.);
- Mallra dhe shërbime dhënë në shtëpi fëmijëve ose atyre që kujdesen për ta;
- Shërbime dhe mallrat e ndryshme dhënë familjeve, të rinjve ose fëmijëve (qendra pushimi ose zbavitjeje);
- Administrim, organizim ose mbështetje të skemave të mbrojtjes shoqërore;
- Shpenzimet për mbulimin e shërbimit të çerdheve nga njësitë e vetëqeverisjes vendore;
- Përfitime në para dhe në natyrë për personat që janë shoqërisht të përjashtuar ose në rrezik për përjashtim shoqëror (si personat në skamje, me fitime të ulëta, imigrantë, indigjenë, refugjatë, abuzues me alkoolin dhe droga, viktimat të dhunës kriminale etj.);
- Përfitime në para, si kompensim page dhe pagesa të tjera për personat e varfër ose të dobët, për të ndihmuar në lehtësimin e varfërisë ose në situata të vështira;
- Përfitime në natyrë, si strehë afatshkurtër dhe afatgjatë dhe vakte ushqimi dhënë personave të varfër dhe të dobët, shërbime dhe mallra për të ndihmuar personat, si këshillim, strehim ditor, ndihmë për të kryer punët e përditshme, ushqim, veshje, lëndë djegëse etj.);
